



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**

*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 30.04.2020, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. Afrim Dina. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. Fatmir Iska, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Të nderuar kuvendarë, këtë mbledhje kemi vendosur ta mbajmë në Shtëpinë e Kulturës për shkak të rrethanave që kemi dhe situatës me të cilën jemi aktualisht, shpresojmë që mbledhjet tjera t'i mbajmë në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Janar-Mars 2020,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279/0, 02280/0 dhe 02281/0
6. Shqyrtimi i informatës mbi mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit kundër korrupsionit 2018-2021.

**Fehmi Hoxha** - Përshëndetje Kryesues, Kryetar, Nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kuvendarë të nderuar, media dhe gjithë ju të pranishëm. I nderuari Kryesues, ne në seancën e kaluar patëm edhe një pikë shtesë të cilën e pata propozuar unë dhe i cili është subvencionimi i bizneseve të komunës së Rahovecit. Shfrytëzoj rastin që të gjithë kuvendarët t'iu përshëndes dhe t'iu falënderoj për mbështetjen ku kemi marr vendim për vlerësimin në dy pikat: e para e propozuar, pra qiranë komunale për 3 muaj të gjithë ata që i shfrytëzojnë objektet komunale mos të paguajnë si dhe të gjithë ata që janë të ngarkuar me taksë komunale të ju zberthehet, pra 3 muaj që mos me pagua. Mirëpo kemi pasur edhe një pikë tjetër ku propozova unë, subvencionim i bizneseve të vogla pra kafiterive, butikëve, artizanatet, rrojtaret, frizerët dhe çdo ekonomi e vogël. Me propozim të Kryetarit, që ka kërkuar dhe ne e kemi mbështetur të gjithë pra shefat e grupeve të partive politike

dhe unë jam pajtuar që për pikën e tretë ta diskutojmë në këtë seancë pra në fund të muajit prill, pasi të marrim informatat bazike nga ana e Qeverisë, ku në fillim nuk kemi pasur informata se çka kanë marr vendim për me ju ndihmua. Prandaj kërkoj që në këtë seancë, përsëri po e përsërisë që me kërkesë të kryetarit jemi dakorduar që në këtë seancë ta vazhdojmë dhe ta diskutojmë pikën e tretë. Unë besoj fuqishëm që Qeveria lokale i ka nxjerrë të gjitha shënimet për ekonomitë e vogla dhe të cilat janë funksionale dhe besoj që do të na prezantojë dhe do ta diskutojmë këtë çështje në këtë seancë, prandaj kërkoj që pikën e tretë që e kemi shtyrë, ta diskutojmë në këtë seancë. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë z. Hoxha, atëherë mund ta diskutojmë edhe këtë pikë si pikë shtesë pas pikave tjera që janë në rendë të ditës, e qesim në votim që ta kemi në diskutim edhe këtë pikë. Atëherë e qesim në votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Para se me filluar pikën e parë të rendit të ditës, unë kisha dashtë që me ftua Kryetarin e Komunës z. Latifi që me na informuar rreth gjendjes aktuale pra situatës në komunën tonë.

**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë ju, i nderuari Kryesues, Nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtarë të kuvendit komunal. Ju e dini se situata me pandeminë Covid-19 ka ndryshuar rrjedhën, edhe në komunën e Rahovecit kemi raste me Covid-19. Rasti i parë i cili ka ndodhur siç e dini një infermiere në fshatin Kramovik por që ka jetuar në Prishtinë dhe ka punuar në Spitalin Amerikan, ajo është e shëruar dhe vetëm është konfirmuar me Covid-19, ajo ka qenë e karantinuar dhe besoj që tani veçse kanë kaluar 20 ditë dhe rasti konsiderohet i shëruar. Para disa dite jeni të informuar se dy punëtore shëndetësore në Repartin e Hemodializës, në vendin e punës kanë marr infeksionin, që të dyja janë punëtore shëndetësore dhe me pastaj janë gjurmuar rastet e kontaktit bashkë me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike kanë rezultuar dhe si rezultat i këtyre dy punëtoreve kanë marr infeksion edhe 14 persona të tjerë që janë kryesisht familjarë të dy punëtoreve shëndetësore pastaj këto dy punëtore kanë imponuar rrethanat që të izoloohen ose të mbyllen edhe tri familje. Disa ditë me pas kemi trajtuar ose janë marr mostrat edhe të pacienteve që marrin shërbimin e tyre në repartin e hemodializës në Prizren dhe nga një numër i konsiderueshëm i pacientëve që janë nga komuna jonë dhe marrin shërbimin në Prizren shumë nga ata kanë dalë negativ por kemi edhe raste të konfirmuara pozitivë siç e kemi rastin në Reti dhe rastin tjetër në qytetin e Rahovecit. Ndërkohë ka vazhduar nëpërmjet punës të Institutit kombëtar të shëndetit publik (IKSHP-së) që është i shtrirë edhe në rajonin e Prizrenit dhe në Gjakovë dhe janë marrë gjurmët e kontaktit po ashtu edhe mostrat edhe për familjarët të cilët janë pacientë në repartin e hemodializës në Prizren. Po ashtu edhe mbrëmë ka dalë edhe një familjar i këtij pacienti që është në hemodializë e që është i shtrirë në Klinikën Infektive në Prishtinë i prekur me Covid-19. Gjendja e këtij pacienti me hemodializë në Prizren e që aktualisht është i shtrirë në Klinikën Infektive në Prishtinë është e dobët pasi ka një moshë të shtyrë 77 vjeçar dhe natyrisht tash që familjari tij ka dal me Covid mbrëmë dhe shpresojmë që të mos komplikohet gjendja e tij. Po ashtu sot presim me i marr mostrat edhe të pacienteve ose të rasteve të kontaktit në Reti dhe rasteve të kontaktit tek pacienti i cili është i shtrirë në Klinikën Infektive në Prishtinë. Numri i rasteve gjithsej në komunën e Rahovecit sipas hartës që e keni parë është 20 ndërsa sipas asaj që ne e dimë është 19, për shkak se nuk e kemi pranuar edhe kemi tërheq vërejtjen që rasti i qytetares nga Kramoviku nuk kemi dashtë me pranuar mirëpo ata IKSHP-ja e kanë vendos kështu. Ne gjithsesi jemi duke përcjellë gjendjen shëndetësore, ekipet tona të QKMF-së bashkë me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHP) duke përcjellur në vazhdimësi gjendjen shëndetësore të pacientëve të identifikuar me Covid-19. Shpresojmë që këto rastet e kontaktit të cilat i marrin sot mostrat nga IKSHP-ja dalin negativ dhe po ashtu shpresojmë që testimet të cilat do të ndodhin gjatë këtyre ditëve te pacientët që do të ju merren mostrat pra pacienteve që janë me hemodializë të dalin negativ. Unë e ndjej për obligim me thanë që ne kemi Covid pozitiv të pacientëve me hemodializë atëherë sigurisht se gjendja vështirësohet, për shkak se fillimisht që gjendja e tyre shëndetësore është e ndjeshme dhe sigurisht që secili rast potencial që konfirmohet me Covid – 19 pastaj i ka edhe kontaktet familjare. Besoj që e ndajmë mendimin e përbashkët edhe kurimin e përbashkët që të kenë shëndet se pari këta që janë me Covid -19 dhe po ashtu të dalin negativ mostrat që merren sot nga rastet e kontaktit me këta dy pacientë, njëri në Rahovec kurse tjetri në Reti dhe po ashtu shpresojmë që parasë gjithash pacientët që janë në hemodializë të dalin negativ siç kanë dalë mbi 13 që janë transmetuar deri me

tani. Këta të tjerët, hiq pacientin me hemodializë që është i shtrirë në Klinikën Infektive në Prishtinë, të gjithë janë në gjendje stabile shëndetësore dhe nuk kanë asnjë simptomë edhe pse janë me Covid-19. Siç e dini, sipas ligjit apo rregullave nuk jemi të obliguar të publikojmë emrat as të rasteve të konfirmuara me Covid por as të gjurmëve të kontaktit që ju merren mostrat e pastaj testohen dhe del rezultati i tyre. Unë e di që jemi vend i vogël pra komunë e vogël edhe flitet gjithçka, me të drejtë e pa të drejtë, ka plot fjalë të bazuara në realitet por sidoqoftë ne i bashkohemi kërkesës pasi Covid-19 është pandemi globale dhe ka përfshirë krejt botën, ka përfshirë Kosovën sigurisht edhe komunën tonë dhe zakonisht është mirë me ditë në këtë rast që virusi tek ne ka ardhë pasi burimin e infeksionit e ka në Repartin e Hemodializës në Prizren dhe ne i kemi rreth 40 pacientë që marrin shërbime pothuajse ka 2-3 herë në javë sipas rregullit qysh e kanë ata në Repartin e Hemodializës. Ne duhet të kërkojmë, përveç që të ju urojmë shëndet këtyre qytetarëve tanë po ashtu duhet të kemi shumë vëmendje bashkërisht sidomos ne si institucione që mos të kemi ndonjë situatë të stigmatizimit sepse kërkushka faj këtu edhe ashtu nuk po dihet se kush ka faj këtu përveç që dimë se ne nuk mundemi me qenë imunë por tani e dimë se burimi i infeksionit është marrë në Prizren konkretisht në Repartin e Hemodializës, dhe ne nuk mund ta akuzojmë repartin e dializës pasi unë personalisht kam qenë disa herë e kam vizituar atë repart edhe besoj që është një repart që ka një higjienë, mirëmbajtje, organizim, rregull të duhur dhe asnjëherë nuk kanë pasur ankesa pacientët por njëkohësisht se është edhe repart i ndjeshëm pra me ndjeshmëri të lartë sepse aty shkojnë pacientë që kanë probleme shumë serioze.

Sa i takon furnizimit me barna esenciale pra maska, dorëza, pajisje mbrojtëse, në kohë të fundit jemi shumë më mirë të furnizuar sidomos në rastin kur janë konfirmuar 14 qytetarët të prekur me Covid-19, Ministria e Shëndetësisë kanë ndërmarr furnizime shtesë të cilat furnizime sigurisht se do të ndikojnë patjetër në mirëmbajtjen, përballimin e suksesshëm të kësaj pandemie. Ne kemi angazhuar po ashtu edhe ekipet tona, që në momentin që kemi marr lajmin për rastin e qytetarëve të prekur me Covid-19, kemi shkuar në vizitë në familjet e tyre dhe bashkë me ISHPK-në janë marr mostrat dhe janë dërguar edhe pako ushqimore higjienike për ata që sigurisht që kanë nevojë, sigurisht që janë dezinfektuar edhe mjediset ku ata jetojnë. Deri me tani kemi shpërndarë afërsisht 1300 pako ushqimore për familjet në nevojë pra familjet skamnore me pako ushqimore higjienike të cilat janë tërësisht vullnet edhe mbështetje e donatorëve të Komunës kryesisht njerëz të vullnetit të mirë, bashkatdhetarë pastaj edhe kompani pothuajse të gjitha i kemi bërë publike edhe i falënderojmë publikisht për të gjitha. Kemi rezerva në depon që e kemi në objektin e komunës dhe sipas rasteve dhe nevojave, Qendra për Punë Sociale është koordinatore, është bartëse, udhëheqëse e krejt procesit të shpërndarjes së këtyre ndihmave.

Masat e reja nga Ministria e Shëndetësisë të cilat priten të fillojnë se aplikuari nga data 4 maj, do jenë kryesisht masa që tregojnë mesazhin e zbutjes së kufizimeve dhe lirim të disa veprimtarive të cilat deri më tani kanë qenë të ndaluara edhe në komunën tonë por edhe në shkallë vendi. Ne kemi qenë dje në një takim me ministrin e Shëndetësisë dhe ministrin Pushtetit Lokal të gjithë kryetarët e komunave dhe unë në emër t'uajin dhe qytetarëve të komunës kam kërkuar që në fazën e parë pra menjëherë me 4 maj, ne jemi të gatshëm të përballojmë hapjen e tregut të përkohshëm edhe në këto kushte pra hapjen e tregut të gjelbër në vendin ku mbahet festivali i rrushit në mënyrë që të ju krijojmë fermerëve, buqëve tanë që t'i shesin produktet e tyre. Kemi pajtim në parim sepse kjo kërkesë nuk është vetëm e kryetarit të Rahovecit por e gjithë kryetarëve të komunave. Besoj që dy ministrat na kanë dëgjuar me vëmendje dhe ne kemi shprehur gatishmërinë dhe kemi mundësi reale tashmë që edhe në këto kushte të hapim tregun edhe këto prodhimet e gatshme të kemi mundësi t'i shesin fermerët pra bujqit tanë, qoftë duke krijuar ndoshta një plan operativ po ashtu edhe atë të gatshëm edhe besoj që do të mundet të ruhet distanca njëri me tjetrin edhe do të mund të funksionoj tregu aty te Shtëpia e Verës dhe kjo do të krijoj stabilitet për fermerët. Masat zbutëse kryesisht kanë të bëjnë me lejimin e veprimeve ndërtimore të kompanive, veprimeve tjera që kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukturë mirëpo këto të gastronomisë ende mbeten të kufizuara p.sh. lokalet hoteliere, restorantet etj. dhe ju do ta keni shumë shpejt listën e atyre që mund ta shihni edhe publikisht. Këto masa zbutëse që i kanë ndarë nëpër faza sipas arsytimit që i kanë ministrat janë kryesisht rekomandime të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, për shkak se ata janë duke përcjellur gjendjen epidemiologjike në Kosovë edhe ata janë të varur nga rregullat ose

rekomandimet që i ka Organizata Botërore e Shëndetësisë. Sido qoftë kërkesat tona janë për zbutjen e vazhdueshme të masave dhe zbutje sa më të shpejt sidomos të disa masave për shkak se edhe ashtu ndoshta nuk e kanë kuptimin me mbajt atë fuqi edhe më tutje të këtyre masave që deri diku kanë qenë të aplikueshme por ka masa që nuk kanë mundur me qenë të aplikueshme për shkak mungesës së kapaciteteve institucionale qofshin të Policisë apo edhe të sektorëve tjerë. Edhe njëherë po them se presim sot testet e reja të bëra nga rastet e kontaktit në Reti dhe në qytetin e Rahovecit dhe eventualisht pacientët të cilët sot shkojnë e marrin shërbimin në repartin e dializës në Prizren. Uroj që të dalin negativ, ndërkohë uroj që ta përmbylim sa me shpejtë edhe besoj që jemi ka fundi i kësaj pandemie, në mënyrë që ti kthehemi sa ma shpejt normalitetit. Faleminderit për vëmendjen tuaj.

**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar për informatën, gjithashtu uroj të gjithë për shëndetin e atyre dhe të mos kemi raste tjera. Të nderuar kolegë, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Të nderuar kolegë, të materialet e procesverbalit që ju keni, e keni deri në pikën e gjashtë të rendit të ditës për shkak se nga ajo pikë kemi pasur problem me incizimin por origjinalin në pikën 7,8,9 dhe 10 e keni të cilën do ju sjellim pasi edhe në e-mail e keni pasur nëse ka mundur dikush me shfletua. A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse jo atëherë e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

#### **2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e Kuvendarëve.**

Nëse dikush ka ndonjë pyetje, unë kam kërkuar që në seancën e sotme të jenë prezentë drejtorët që kanë pika aktuale ndërsa përgjigjet mund t'i marrin edhe mbledhjen e radhës.

**Masar Popaj** – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë dhe ju kolegë delegatë. Unë kam një kërkesë që me ka ardhë nga një lagje e fshatit Fortesë në lidhje me rrugën katër korsi. Më drejtohet mua, ju si asambleistë i Kuvendit Komunal në Rahovec dhe si përfaqësues i banoreve të fshatit Fortesë. Ne disa nga banoret e fshatit Fortesë, Ali Gashi, Bashkim Gashi, Agim Gashi, Selami Gashi, Nazmi Gashi, Ali Gashi, Faik e Selim Gashi etj. po ju drejtohem juve si përfaqësues i Kuvendit Komunal të ngritni zërin në Asamblenë komunale dhe te Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi, në lidhje me shqetësimin tonë sa i përket ndërtimit të rrugës me katër korsi Rahovec-Fortesë-Xërxë. Shqetësimi i ynë kryesor ka të bëjë me trasenë e kësaj rruge e cila fillimisht gjatë matjeve që janë bërë vitin e kaluar kanë qenë saktësisht në pika të cilat shihen në fotot e bashkangjitura nga gjeoportalet e që i përkasin pronës publike. Ndërsa në matjet e fundit që janë bërë nga kompania e angazhuar për kryerjen e punimeve, këto pika kanë lëvizur befasisht ku është ikur nga prona publike rreth 3-3.5 metra dhe lihet e zbrazet pjesa e pronës publike nga ana e kundërt dhe për të njëjtën gjatësi është futur nga ana e jonë në pronë private. Gjithashtu duhet të cekim se për pjesën për të cilën po flasim gjerësia e pronës publike është afërsisht 16-18.3 metra. Tjetër shqetësim i yni është që vetëm 1-1.5 metra nga asfalti është edhe gypi kryesor i ujësjellësit që e furnizon qytetin e Rahovecit dhe shumë fshatra të tjerë, ku në rast të ndonjë dëmtimi eventual i këtij gypi atëherë pasojat dhe dëmet që do të mund të shkaktoheshin do të jenë të paimagjinueshme dhe për një rast të tillë do të jetë Kuvendi Komunal i Rahovecit. Gjatë gjithë prezantimit të këtij projekti dhe prononcimit të zyrtareve komunalë dhe po ashtu të kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi është deklaruar se projekti i rrugës me katër korsi do të jetë 99.9% të gjatësisë nuk preket prona private por vetëm ato publike. Prandaj ne si pronarë të këtyre pronave, jemi kategorikisht kundër kësaj zhvendosje të trasësë, së kjo është e papranueshme për dhe se pronat tona nuk mund të shpronësohen me shitje dhe për asnjë lloje kompensimi. Dyshimet tona janë se dikush po tenton që qëllimisht po e bën trasenë e kësaj rruge dhe në këtë mënyrë po shpërblehen uzurpatorët e pronës publike dhe që ndëshkuan pronarët e tokave nga pjesa tjetër dhe njëkohësisht të dëmtohet që ka biznese që operojnë në këtë pjesë e disa prej të cilave rrezikojnë të mbyllën përfundimisht, që për neve është absolutisht e papranueshme. Gjithashtu ju njoftoj se pas vendosjes se këtyre pikave, në ishëm në Komunë dy herë, me datën 13.04 dhe 22.04.2020 dhe kemi kontaktuar

me drejtorin e Shërbimeve Publike z. Përparim Krasniqi ku kemi kërkuar sqarime rreth këtyre matjeve dhe i njëjti është deklaruar që mund të ketë ndonjë gabim në matjet dhe në një kohë sa me të shkurtër të bëhet matja e pronës publike në atë pjesë dhe kemi kërkuar precizimin e projektit të kësaj rruge, por që kjo nuk ka ndodhur dhe projekti nuk na është prezantuar dhe pas premtimit nga ana e tij gjithashtu nga i njëjti kemi marr nga dyja takimet, premtime që do të dilet në terrene deri me datën 24.04.2020 dhe do të bëhet matja e pronës publike por as ajo deri me sot nuk ka ndodhur. Ne si banorë dhe pronarë të këtyre pronave, theksojmë se nuk jemi kundër ndërtimit të kësaj rruge por jemi kundër kësaj fatkeqësie që po na bëhet dhe kërkojmë që të shqyrtohet prona publike dhe mos preket prona jonë private. Ne fillimisht do të i shtjerrim të gjitha mundësitë që këtë shqetësim ta zgjedhim në mënyrën me të mirë të mundshme pranë organit kompetentë komunal. Mirëpo nëse kjo nuk mund të arrihet dhe shqetësimi jonë hasë në vesh të shurdhër atëherë do të jemi të detyruar që ti adresohemi zyrës ligjore për mbrojtjen e të drejtës së pronës tonë, e cila në emrin tonë do të na përfaqësoj dhe do ti drejtohem organit komunal, mediave, avokat të popullit, prokurisë, gjykatës dhe gjitha organeve tjera kompetente. Duke shpresuar se kërkesa jone do të merret parasysh pranë organit kompetentë dhe përfaqësimit të denjë nga ana e juaj. Ju faleminderit paraprakisht.

**Munib Durguti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. I nderuri kryesues, kryetar, të nderuar kolegë, drejtorë të drejtorive. Unë e dëgjova me kujdes kryetarin e Komunës i cili e shpali aktivitetin që e ka ushtruar për sajimin e gjendjes dhe marrjen e masave dhe e përgëzoj për këtë angazhim për këto ditë, e kemi përcjell me vëmendje gjatë gjithë kohës. Problemi që dëshiroj ta shtroj këtu është një shqetësim që është ngritur nga disa qytetarë konkretisht furrarë që e shesin bukën pa masa mbrojtëse. Unë nuk po dyshoj që janë marrë masa dhe janë tërheq vërejtje atyre në mënyrë të vazhdueshme mirëpo në komunën tonë ende vazhdon të shitet buka me dorë dhe nuk i zbatojnë as standardet minimale, nuk po flasim në përgjithësi por në 80% të rasteve. Ky është shqetësim që kam deshtë me ngritë në seancën e kaluar por jemi dakorduar që për shkak të kohës që seanca të jete sa me të shkurtër mirëpo edhe vllugun e rritjes së përhapjes së infeksionit ata aspak nuk janë të vëmendshëm dhe aspak nuk janë të gatshëm t'i respektojnë standardet minimale. Unë i kujtoj kohën që nga studimet në Prishtinë para shumë vitesh që ka qenë një standardë që produktet e miellit janë shitë me dorëza dhe shitësi ka qenë gjithmonë i pajisur me një kapelë, këto janë standarde unike që duhet respektuar pavarësisht përhapjes së infeksioneve apo pandemive të ndryshme. Në këtë situatë unë besoj që kjo nuk duhet të tolerohet aspak dhe ftoj kryetarin dhe drejtorin e inspeksionit që të marrin masa konkrete, kështu si i kanë graduar inspektorët me punë shtesë që të jenë të pranishëm në terrene dhe të inspektojnë edhe rezultatit e këtyre punimeve që i bëjnë, kjo është.

**Shqiçe Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë. Unë kisha pak si shqetësim në fushën e arsimit, përderisa unë veç punoj në arsim. Prej se ka filluar mësimi online, i kemi disa nxënës që nuk kyqen, arsyeja jo pse nuk kanë dëshirë por nuk kanë mundësi. A do të kishte ndonjë mundësi që me ju ndihmuar këtyre nxënësve që mu kyq edhe këta, pasi janë disa familje që të dy prindërit nuk i kanë në punë apo tre fëmijë i kanë në shkollë dhe nuk mundën me i shfrytëzuar në të njëjtin interval kohorë 3 apo 4 fëmijë në të njëjtin telefon dhe për shkak të kushteve janë shumë të mirë sidomos në shkollën “Selajdin Mullaabazi- Mici” janë paraqitur disa raste dhe kujdestarët e klasave e kanë shpreh se arsyeja për ata nxënës është për shkak të kushteve financiare nuk mundën me u kyq në mësimin online. Faleminderit!

**Ali Zhuniqi** - Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtorë dhe ju gjithë anëtarë të kuvendit. Fillimisht e përgëzoj kryetarin për punën që në bashkëpunim me IKSHP-në dhe Ministrinë për punën jashtëzakonisht të mirë që ka bërë dhe mendoj që duhet vlerësuar edhe me gjithë rrethanat dhe menaxhimin e kësaj situate edhe për sanimin e të gjitha masave mbrojtëse. Duhet përgëzuar të gjitha institucionet që kanë treguar një punë jashtëzakonisht të mirë dhe të rëndësishme për menaxhimin e kësaj situate. Por, sot nuk desha me diskutua meqenëse jemi në një situatë të tillë edhe me ju shmangë debateve kështu në përgjithësi por desha me u lidh me Masarin pasi nuk

mundem pa e diskutuar edhe me i thëne se ti ke rënë në kundërshtim me vetën me këtë shqetësim të qytetareve për arsye se je ti pro kësaj autostrade dhe nëse doni edhe ta argumentojë andaj edhe nuk është mirë edhe ata qytetarë që kanë ngritë këtë lloje shqetësimi që e keni bërë, mendoj që është i vonuar nga ana juaj edhe për këtë arsye nuk është mirë me dal këtu edhe me thanë se kinse je duke e kundërshtuar por në të njëjtën kohë keni mbajtur takime që ky projekt me u bo edhe kur e dimë që tash ky projekt është drejt fazës finalizimit andaj edhe nuk është mirë me bo politikë në këtë kohë. Mendoj që është dashur me u kursye edhe këtë diskutim me bë në një seancë tjetër. Faleminderit!

**Kryetari** – Unë i kuptoj shqetësimet të cilat i ngriti asambleisti Masar Popaj, ende aty nuk ka shkua kadastra me i bo matjet e sakta, dikush bazohet në gjeoportale e dikush ne shenjat që i ka vendos gjeodetët e kompanisë, i kam takuar edhe vetë personalisht kush janë ata qytetarë. Edhe unë jam dakord kjo çështje nuk ka nevojë me u parë me urgjencë pasi ende nuk ka mbërri puna deri aty dhe ju siguroj që rruga katër korsi do të bëhet pasi ajo është kontratë por vetëm situata me pandeminë na ka vonuar sepse do të ishte kryer një pjesë e madhe e punës në kuptimin e angazhimeve por rasti me Pandeminë e ka vonuar projektin. Ne askujt nuk do të ja shkelim të drejtën, e dimë çka është prona publike dhe e drejta mbi pronën publike po ashtu edhe prona private edhe e drejta e shenjtë e pronës private, po ashtu e dimë se çka janë shpronësimet dhe këmbimet e pronave edhe sigurisht i kuptojmë po ashtu edhe shqetësimet edhe të atyre pasi kanë qenë mbi dhjetë herë në Komunë dhe mbi 5 herë i ka takuar drejtori i Shërbimeve publike dhe nuk kanë nevojë për asnjë shqetësim sepse këtu askush ne ditët e sotme me mashtrua askënd dhe të ja mohoj të drejtën e tij që i takon, pasi ka ligj dhe rregulla ky vende, ka kadastrë, agjencion kadastral ky shtet d.m.th. gjithçka besoj që do të shkoj dhe jam shumë i bindur që kryesisht do të përdoret prona publike në përmbushje të qëllimit për me realizua rrugën katër korsi Rahovec-Xërxe. Pra, ato shqetësime janë legjitime pasi janë qytetarë tanë edhe besoj që drejtorja e Shërbimeve Publike, menaxhmenti i kontratës, kadastra jonë ka jashtëzakonisht mundësi me zgjidhë edhe me i tejkaluar çfarëdo shqetësimi sepse aty tregon saktë se e kujt është prona dhe në premtimet dhe zotimet të cilat i kemi dhanë do t'i mbajmë, për shkak se ju kemi thënë se do ta përshtatim projektin me gjendjen faktike në terren. Ndërsa ata që hyn në pronën publike edhe ata do të përpiqemi me i ruajt, ndoshta nuk kanë shumë të drejtë me ngritë zërin sepse ata kanë hy në pronë publike, po besoj që ne ja kemi terezit mos me dëmtua as ata që kanë hy në pronë publike në këtë rast dhe as ata që janë në pronë private, gjithsesi gjithçka ndodhë me marrëveshje pra me koordinim edhe nëse ju marrim pronat private natyrisht se ne merremi vesh dhe shohim se a ka mundësi të shpronësimit apo këmbimit, por besoj që nuk ka asnjë problem edhe punët do të vazhdojnë me intensitet të shtuar pra do të kemi një intensitet të punimeve në rrugën katër korsi edhe duhet me ditë secili i ka detyrat, rolet dhe përgjegjësitë e ndara por gjithsecili e ka për obligim me qenë në zbatim të ligjit edhe unë si kryetar edhe secili qytetarë dhe secili që është i veshur me përgjegjësi ose edhe ai që fare s'ka përgjegjësi publike. Unë nuk po dua me hy ne debate që i bëjnë dy delegatet e nderuar Aliu dhe Masari pasi janë çështje të tyre që fare nuk janë relevante për këtë seancë. Tek furrtarët, ne kemi vendim edhe të shtabit po ashtu edhe kërkesë që buka ose produktet që i gatujmë furrtarët tanë të jetë me standarde dhe të shitet me standarde, ka mundësi që ndoshta dikush edhe nuk i respekton. Ne ju kemi tërhequr vërejtjen disa herë përmes inspektoratit edhe këta e di se dhe ne kushte kur nuk ka pandemi duhet të ketë standarde minimale. Unë do ta angazhoj dhe do ta ftoj inspektoratin edhe njëherë edhe nga kjo seancë edhe njëherë edhe në emër tuajin që të kemi më shumë kujdes te furrtaret pra shitësit të bukës dhe prodhimeve tjera që i gatujmë ata. Po ashtu edhe shqetësimin që ngriti Shqipe Kryeziu, që kishte një shqetësim legjitim dhe të ju them të drejtën dhe unë e di që kryetari i Komunës së Prishtinës Shpend Ahmeti ka dhënë një mundësi me shkua dhe me furnizua ata që kanë nevojë për teknologji informative për të pasur mundësi për tu futur në sistemin online të mësimin. Ne nuk i kemi ato ndoshta ato mundësi por nuk kemi edhe adresa specifike në adresë të Drejtorisë komunale të Arsimit dhe Kryetarit të Komunës por nëse do të ketë këso kërkesa atëherë vërtet edhe ne do të jemi të interesuar të

marrim veprime të caktuara, ndoshta jo shumë por aq sa kemi mundësi pasi ka edhe një donacion nga ETC-ja me 460 pajisje elektronike që mund të ndihmojnë në përfshirjen e sistemit të mësimin online dhe pse jo të kërkojmë edhe ndihmën e dikujt por nuk kemi specifikisht asnjë kërkesë zyrtare që ndoshta mund të ketë edhe shumë më tepër që mund t'i dimë por ndoshta edhe njerëzit edhe hezitojnë me treguar por nëse kemi kërkesë zyrtare do ta trajtojmë menjëherë. Faleminderit!

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, kryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët dhe gjithë të pranishmit. Unë deshta me i ngrit dy çështje shkurtë, para DDD-ja (dezinfektimi, dezinfektimi, deratizimi), mendoj se është koha që duhet të bëhet në Rahovec dhe ajo nuk po bëhet. Është shume me rendësi, pasi sezona e thumbimit me rriqra ka filluar pasi Komuna e Rahovecit bën pjesë në grupin e komunave si treva endemike e që kemi raste që veç kanë fillua pasi edhe me parë jemi ballafaqua me epidemi të shkaktuara nga pickimi i rriqrave. Kujtoj se vitin e kaluar nuk është kryer DDD-ja, në mbledhjen e kaluar kur e kemi shqyrtuar planin e veprimit të zyrës se prokurimit, e kemi parë që procedurat e prokurimit fillojnë pak me vonesë në muajin Prill sa me kujtohet dhe unë kam kërkuar që të bëhet me herët në mënyre që procedurat pasi ato zgjasin se paku një muaj edhe të kryhet me herët, pasi sezona ka fillua edhe DDD-ja duhet të kryhet sa ma herët. Muaji Maj edhe Qershor është koha që ne e kemi këtë problem prandaj kjo duhet të kryhet sa ma shpejt, kujtoj se vitin e kaluar ka dështuar pikërisht për shkak të vonesave në procedurën e Prokurimit. E dyta, tuneli i dezinfektimit, pra është një aparat i cili përmes dezinfektimit bëhet parandalimi i përhapjes se infeksionit me Korona virusë Covid-19. Ne dimë që në komunën tonë janë 3 sosh dhe unë mendoj se një e tillë e ka vendin në QKMF, për arsye se aty është vija e parë e frontit dhe aty ballafaqohemi me se shumti me këtë problem edhe me virusin edhe me punëtorët shëndetësor edhe me qytetaret që vinë aty. Nuk po them që është deshtë me qenë e para, e dyta apo e treta por munde të jetë e treta edhe e katërta sidoqoftë mendoj se ju duheni me u angazhua pra pushteti me na sjellë një aparat të tillë në QKMF në Rahovec. Faleminderit

**Masar Popaj** – Ishte një shqetësim i ngritur i qytetareve të Fortesës edhe Alia që e tha se jeni pro kësaj rruge dhe është e vërtet se jam pro e kësaj rruge me katër korsi por jo mu dëmtua qytetaret edhe qytetaret e dinë se ku me u orientua dhe janë ardhë te unë qytetaret e fshatit Fortesë dhe ti jeton në Prishtinë dhe nuk e din se në çfarë gjendje është fshati Fortesë kështu që jam për rrugën me katër korsi dhe jo mu dëmtua qytetaret e fshatit Fortesë dhe kjo është arsyeja dhe ju me ato mendimet e tuaja të kota që i jep dhe nuk vlerësohesh hiq, unë nuk brengosem hiq për këtë.

**Ali Zhuniqi** – Për shkak të situatës që jemi, nuk po dua me diskutua edhe mendoj që e keni gjete pak kohën e vonuar edhe për shkak të procesit të realizimit, po ashtu edhe kryetari e tha kjo tani veç i kish marr përmasat e intensitetit jashtëzakonisht të madhe sa i përket aspektit të punës dhe si shqetësim të qytetareve ke të drejtë me u shqetësua edhe unë po ashtu nuk kam qenë kundërt edhe kryetari në postimin që kam bërë unë, ka nxjerrë prej kontestit pasi nuk kam qenë kundërt dhe isha pro situatës por mundësisht duke mos i dëmtuar pronat private në të njëjtën kohë dhe nuk jeni ju ai që me vlerësoni mua pasi me kanë vlerësuar qytetaret.

**Kryetari** – Besoj që po e përmbylim tash këtë pikë, faleminderit z. Cena DDD-ja pra dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi është e vërtet se nuk ka ndodhur vitin e kaluar për shkak se lënda është në OSHP-ë dhe jo në prokurim tek ne dhe po shpresoj se tash do të na kthehet një përgjigje pozitive për me pas një normalitet në kuptimin e zbatimit të kësaj kontrate. Pra me kohë janë kryer procedurat por ka pasur ankesa nga OSHP-ja deri këtë vite pasi OSHP-ja është gjykata në tender siç e dini të gjithë edhe përgjegjësi e plotë e tyre dhe nuk pyesin as komunat dhe as institucionet tjera për shkak se kanë kompetencën e vendim marrjes vetë. Ndërsa sa i takon tuneleve dezinfektuese kemi konsultua edhe drejtorin e Shëndetësisë z Samir Mustafa, se ka pasur një hezitim të vendoset për shkak të punimeve edhe te gjendjes jo të mirë në mjediset ku punohet sot. Ju e dini se objekti i ri është ka përfundimi prandaj jemi munduar me gjete një vende tek semaforët që po të kish pas dikush mundësi me i orientua të gjithë aty para se me marr shërbime me hije në tunele por sido qoftë

kërkesa është me vende dhe pajtohem plotësisht se stafi shëndetësorë është në vijën e parë të fronit po ashtu edhe Policia e Kosovës dhe ne si shtabe e posaçërisht ju si stafe shëndetësore edhe me muajt me sjellë edhe një nëse kemi mundësi edhe nëse është nevoja do ta tërheqim prej komunës. Arsyeja se pse kemi qitë në Komunë është për shkak të aplikimeve në komunë dhe ta tash masa e 15-të që po aplikohet ka shume aplikime në QPS dhe entit të punësimin dhe besoj që nëse edhe unë nuk jam për te diskutuar atëherë kjo është masë, kjo si rend dite që u shtua nga shefat e grupeve dua të ritheksoje edhe njëherë se komuna nuk ka mundësi me marr vendim për me i mbështet bizneset për shkak të kapaciteteve të ulëta buxhetore dhe pothuajse të gjitha bizneset edhe këto të Gastronomisë po aplikojnë në masën 15 për tu përfshirë rehabilitimin ose trajtimin nga ana institucioneve të Republikë se Kosovës dhe nuk është mirë ne ngutë dhe me i subvencionua pasi edhe s'kemi fuqi financiare pasi kërkesat janë të mëdha dhe e di që është numri i madh i aplikuesve edhe në komunën tonë që po aplikojnë edhe bizneset e vogla si kafiteritë, kioskat pra edhe punëtorët edhe firmat janë duke aplikuar dhe shpresoj që Kuvendi i Kosovës t'i jep zgjidhje pakos emergjente për rimëkëmbjen ekonomike ose për trajtimin e situatave të rënda nëpër të cilën po kalojnë bizneset tona në përgjithësi të vogla të mesme edhe të mëdha. Pra, komuna jonë vështirë e ka me i mbështet një numër kaq të madhe të bizneseve për dy muaj me pako financiare pasi sikur të ishim Prishtina apo Prizreni do të ishim ma ndryshe pasi kanë një buxhet seriozë. Po ashtu po ju jap edhe një informatë, pasi ne presim 10 milionëshin me marr si grand nëpër komuna për pandemi, që shume shpejt pritet të fuqizohet dhe besoj që edhe komunës tonë i takojnë më shume se 200,000 euro, si grand për të gjitha komunat që e ndan Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal për pandemi dhe nëse na vjen ky grand në këtë përbërje siç jemi, me siguri do të përpiqemi me destinua sa ma mirë që është e mundur edhe me i zgjedh pozicionet më të vështira që janë më të nevojshme dhe të domosdoshme për t'i mbështetur. Faleminderit shumë!

**Aferdita Thaqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për ju kryesues, kryetar, drejtor. Për mbledhjen e ardhshme kërkoj që nëse jemi në këso gjendje, pika e dytë duhet të hiqet pyetje dhe përgjigje nga rendi i ditës. Përpos shqetësimit shihet se gjërat tjera janë shumë të panevojshme edhe koha që na keni mbajta këtu edhe për shkak të gjendjes kaotike që jemi duhet të hiqet kjo pikë. Pikërisht doktori është dashur në rend të parë me propozua këtë pikë.

## **2. Shqyrtimi i raportit financiar janar- mars të vitit 2020.**

**Afrim Limani** - I nderuar kryesues, kryetar, drejtor, asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm. Raporti financiar 3-mujor është pak më ndryshe në krahasim me raportet tjera dhe ne si drejtori e Financave jemi munduar që të paktën ta thjeshtësojmë, ta modifikojmë në mënyrë që të jetë me i kapshëm dhe më i afërt për ju, pra e kemi bërë koncentrimin e shume faqeve në kuadër të një faqe. Raporti financiar përbëhet prej dy pjesëve: pjesa e të hyrave vetanake dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Pjesa e aktiviteteve të prokurimit nuk janë të futur në këtë raport për arsye se brenda kësaj periudhe nuk kemi pasur ndonjë aktivitet nga ana e zyrës së prokurimit. Trendi i të hyrave vetanake deri me 15 mars ka qenë mjaft i mirë mirëpo pas kësaj date ka një rënie të dukshme të theksuar e cila vazhdon edhe gjate muajit prill edhe mos të them se nuk kemi fare të hyra të realizuara. Brenda 3 muajve kemi një inkasim të të hyrave me vlerë prej 244,511 që n'krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një ndryshim negativ me vlerë prej 2,445 euro, mirëpo bashkë me gjobat e gjykatave dhe trafikut të hyrat vetanake janë prej 296,301 euro që kur e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë diferenca është pozitive 9,349 euro, për atë që ju e keni këtë informatë në raport sepse pas dorëzimit të materialit na ka ardh raportit i të hyrave nga gjobat e trafikut për muajin Mars që vlera e tyre është 12,216 euro do të thotë para 3 dite na ka ardh raportit. Ndërsa të hyrat nga tatimi në pronë, brenda kësaj periudhe kemi 92,436 euro dhe kur e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë kemi një ndryshim negativ me vlerë prej 12,368 euro. Realizimi i buxhetit-përkundër miratimit të vonshëm të buxhetit nga niveli qendror, mirëpo sipas ligjit të Financave publike dhe përgjegjësive dihet se për çdo muaj alokohet 1/12 e buxhetit dhe krejt në fund të muajit mars e kemi edhe të 3-mujorit të

dytë të buxhetit ku kemi një alokim prej 6,377,000 dhe brenda kësaj periudhe kemi arrite që të bëjmë një shpenzime me vlerë totale për të gjitha kategoritë prej 2 666 000 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, komunal, kapitale, paga dhe mëditje. Përqindja e realizimit të buxhetit brenda kësaj periudhe është 18.9%. Në faqe 8,9 dhe 10-të kemi shpenzimin e buxhetit një tabelar ku i kemi paraqitë shpenzimin e buxhetit në kategori ekonomike në mallra dhe shërbime dhe për krejt ne fund, unë desha me bo një sqarim pra në faqe 8 në kuadër të kuvendit komunal për dreka zyrtare kemi një shpenzim të buxhetit me vlerë prej 1774 euro dhe desha me ju informua se këto shpenzime nuk i ka bërë Kuvendi Komunal mirëpo sa për informimin tuaj që nga viti 2014 e kemi një vendim që ka aprovua kuvendi komunal për shoqatën „Ekzodi,, dhe ata bëjnë disa aktivitete që kryesisht shpenzimi që bëhet e kanë karakterin dreka zyrtare dhe vlera e shpenzimit është 1300 euro andaj kërkesa ime para juve është në cilësinë e drejtorit për buxhete dhe financa që ta anuloni këtë vendim, në mënyrë që apsolutisht nuk jam kundër kësaj shoqate dhe jam për me i ndihmua mirëpo ndihmesa ekziston ne forma tjera pra ne mundemi me ju ndihmua përmes subvencioneve ku bëhet përmes thirrjeve. Pra pse me figurua ky shpenzim për dreka zyrtare fryhet ky kod edhe dihet se raporti publikohet edhe mundet ta shohin krejt qytetarët dhe konsideroj se është e paqëllimshme, do të thotë se ju jeni ata që mundeni me marr një vendim për anulimin e vendimit të mëhershëm mirëpo ne kërkesën e tyre gjithsesi me pranue por përmes subvencioneve. Faleminderit

**Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sjelljen e këtij raporti, gjithsesi edhe këtë pjesë sa i përket ku nuk figuron bash mirë aty te shpenzimet e Kuvendit për dreka zyrtare pra kjo është pjesë e ndihmës që eksodi e ka me një vendim të mëhershëm por do të shohim edhe do ta trajtojmë në një mbledhje tjetër të ardhshme të Kuvendit.**

**Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë. Te mallrat dhe shërbimet sipas programeve kemi vërejt se te disa kode kemi rritje të shpenzimeve pra tek tabela A faqe 5, kodi 13480, shpenzimet për anëtarësim 2,810 euro për vitin 2019 ndërsa për vitin 2020 kemi 7,000 euro dhe furnizime për zyre kodi 13610, në vitin 2019, kemi vetëm 130 euro kurse për vitin 2020 kemi 2,508 euro, karburant për vetura kodi 13780 në vitin 2019 kemi 1,321 euro ndërsa në vitin 2020 i kemi 3,344 euro edhe tek dreka zyrtare, kodi 14310 në vitin 2019 kemi vetëm 78 euro ndërsa për vitin 2020 kemi 2,367 euro. Po ashtu edhe tek faqe 9, tabela B gjithashtu karburant për vetura 13780 ne vitin 2019, 634 euro kurse për vitin 2020 është 1,610 euro, tek faqe 10 tabela C shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit tonë kodi 13133 në vitin 2019 ishte 3,125 euro, kurse për vitin 2020 është 6,583 euro. Besoj që drejtori që do të na jep sqarime.**

**Rasim Fazliu – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit Komunal, drejtorët, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Fillimisht e falënderoj drejtorin për këtë raport 3-mujor financiar. Është e vërtet se në këtë periudhë gjendemi në një vështirësi edhe si komunë për shkak të pandemisë pasi jemi bllokuar në të gjitha segmentet por edhe më gjerë pasi i gjithë rruzulli tokësorë që kemi probleme por sidoqoftë shihet se është diçka, pra janë bërë disa lëvizje. Unë desha fillimisht drejtorit gjegjësisht kryetarit t'i drejtohem që ka qenë mirë ndoshta ky raport i përfshirë edhe Plani vjetor i prokurimit, fakt e kisha fjalën për Prokurimin pasi desha të ndërlihem se ne e kemi pasur në shqyrtim planin vjetor të prokurimit edhe në këtë plan vjetor kemi parë ka pas aktivitete që do të bëhen edhe në janar, shkurt, mars kështu që ndoshta është dashur të përfshihet edhe prokurimi këtu e që nuk e kam parë askund që është. Pastaj vazhdojmë te të hyrat e rregullta për vitin 2020, desha me cekë që të hyrat e rregullta të realizuara në baza për këtë 3 mujorë, shihet që edhe pse ka qenë vështirësi, realizimi i të hyrave është bërë sikur në vitin 2019 në njëfarë mënyrë, mirëpo nëse e shohim te planifikimi mund të themi se ndoshta për vitin 2019 planifikimi ka qenë më i vogël dhe për vitin 2020 planifikimi është më i madh edhe sigurisht që për shkak të rrethanave karshi planifikimit që është për vitin 2020 është për 44,620 euro me pak, por sigurisht duhet me marr parasysh edhe situatën që jemi. Pastaj, për gjobat nga trafiku dhe gjykatat, drejtori na dha informacione dhe po shihet se gjobat në trafik kanë rritje goxha të madhe ndërsa gjoba të gjykatave ne nuk kemi në raport**

por vetëm 20 euro si shume e cekur aty. Kalojmë te realizimi i të hyrave sipas kodeve ekonomike faqe 4, desha të shkoj te kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi, planifikimi 17,700 euro është për vitin 2020 ndërsa janë realizuar vetëm 542 euro d.m.th. sigurisht drejtori na jep sqarime pasi kemi një realizim mjaftë i vogël por sigurisht që do të marrim informata se pse ka ndodhur kështu pastaj kemi kodin 50026 taksa për legalizimin e objekteve, planifikimi është 14,200 euro mirëpo është për të mirë për shkak se edhe realizimi është bërë për këtë 3-mujor pra është diçka shumë mirë kjo dhe muajt tjerë veç pritet të tejkalohet ky realizim, pastaj kemi kodin 50405 shfrytëzimi i pronës publike që është paraparë në planifikim 13,000, euro ndërsa janë realizuar 270 euro edhe këtu është një realizim i vogël. Pastaj kemi te participimet nga bujqësia mungon kodi dhe nuk e di pse kjo po ndodh çdo vite dhe asnjëherë nuk është kodi, nuk e di pse kjo, mendoj që njëherë mundet me ndodh gabimi mirëpo jo çdo vit pra çdo herë që sillni raportin, te participimi në bujqësi mungon kodi dhe është mirë me evituar këtë gabim. Pra, sa i përket kësaj për këto që i ngrita sigurisht që do të na jep sqarime të mëtutjeshme. Pastaj në faqe 5, ku e cekem te planifikimi i realizimit të tatimit në pronë, në vitin 2019 realizimi ishte më i madh se sa planifikimi ndërsa në vitin 2020 realizimi i tatimit në pronë është më i vogël se sa planifikimi për 42,837 euro. Pastaj te realizimi i buxhetit- edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar dhe e kemi ngritë këtë çështje, që mund të themi shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike, nëse e bëjmë krahasimin mes fondeve të alokuara dhe të shpenzuara, shohim se nga 6,377,568 euro të alokuara janë shpenzuar vetëm 2,666,166 euro. Kjo tregon se pak është shpenzuar buxheti i alokuar, e kam përmendur faktikisht te kapitalet janë alokuar 1,704,663 euro kurse janë shpenzuar vetëm 574 euro, edhe për këtu besoj që drejtori do të na jep informata, ndoshta bazohem edhe nga situata në të cilën jemi sepse pak a shume jemi duke jetuar në kushte të jashtëzakonshme. Po ashtu tek tabela A në faqe 8, shpenzimet nga vendimet e gjykatave d.m.th. te administrata 2,475 euro desha informata rreth kësaj. Faleminderit për vëmendjen tuaj.

**Ali Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuari kryetar, të nderuar kolegë asamblistë. Sa i përket realizimit të të hyrave nuk do isha ndalur, meqenëse është një realizim i mirë, unë po besoj që në 3- mujorin e dytë të këtij viti do të kemi pak vështirësi për shkak të pandemisë dhe disa vendimeve që kemi marr në seancën e kaluar për me i lirua bizneset nga qiraja dhe taksa komunale. Po ashtu kisha me u ndërlidhë të z. Fazliu që e ceku, tek inkasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomikë pikërisht tek kodi 50009 taksa komunale për leje ndërtimi, edhe ne raporte tjera financiare kur na ke sjellë drejtor e kam paraqitu si vërejtje pasi planifikimi është 17 700 ndërsa realizimi është i ulët që e ceku edhe z. Fazliu mirëpo unë sa e kam kuptuar realizimi i të hyrave për këtë kategori është bërë te kodi 50503 inspektimi i planit urbanistik ku kemi një realizim prej 3982 euro, po besoj që është për të njëjtën rast fjala, atëherë mendoj se duhet me përmirësua këtë pasi nuk e di a është gabim teknik apo diçka tjetër pra planifikimi duhet të bëhet të ky kodë ose të mbetet tek taksat komunale për leje ndërtimi. E dhe një pyetje tek borxhet ku e ceku edhe z. Fazliu, ne e dimë që tash shumica e arsimitareve kanë paraqitur në fakte e kanë paditur drejtorinë e arsimit për realizimin e disa obligimeve pra përmbushjen e kontratës kolektive që e ka nënshkruar qeveria e Kosovës me Sindikatën e Arsimit dhe unë dua të di se a keni shifra se sa është borxhi kontingjent për këtë kategori edhe a ka buxhete komuna për me pagua këtë kategori apo si do të ndodhë pagesa e këtyre vendimeve gjyqësore. Faleminderit!

**Rukie Krasniqi** – Përsëritje për ju kryesues, kryetarin dhe gjithë këshilltarët e Kuvendit Komunal dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë sallë. Unë më tepër kisha dashur me ditë që për të ardhmen se sa kish me ndihmuar apo me kontribua, e kam fjalën tek shpenzimet sipas programeve të drejtorive e veçanërisht tek administrata e arsimit. Te pjesa e subvencioneve dhe transfereve-a mund të subvencionohen klubet e shkollave, grupet e nxënësve apo nxënës individual me projekte të ndryshme që mund të ngritin kriteret apo konkurrencën ndërmjet tyre në cilësinë e arsimit apo neper aktivitete të ndryshme kreative që mund të

pasurojnë edhe me tepër kreativitetin e tyre në shkollë dhe jashtë saj. Unë e kisha këtë për të ardhmen apo sa po realizohet kjo, meqenëse nuk e pash se nuk ka as subvencionime dhe transfere të këto pozita.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, edhe unë fillimisht e falënderoj drejtorin për prezantimin e këtij raporti të buxhetit për periudhën e 3-mujorit të parë për vitin 2020. Mendoj se është raport i qartë dhe i saktë por unë i kam disa vërejtje të mia dhe ndërhyrje rreth gjendjes së buxhetit. Tek të hyrat edhe pse drejtori i ceku, nuk është e tepërt që ne me dhanë mendimin tonë, në 3-mujorinë parë në raport me planifikimin e buxhetit vjetor në përqindje, unë e shoh se është diku 21% që është realizuar pra me pak se është planifikuar, pasi është dashtë se paku 25% ose që ajo që është planifikuar pastaj edhe në raport me vitin 2019 ka me pak pra të hyrat janë me vlerë negative, në raport me planifikimin 3-mujorë nëse shikohet ajo çka është planifikuar dhe ajo çka është realizuar është 84.5% po shihet se është vlerë negative. Te gjobat, e ceku se ka rritje gjobat në trafik dhe gjykatë edhe pse këto nuk janë të hyra relevante, meqenëse ato tash derdhen në nivel qendror në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Te tatimi në pronë, mendoj se është një element shumë i rëndësishëm sepse të hyrat nga tatimi në pronë, është më obligatorë dhe më i mirë që e vlerësoj edhe unë i qeverisë lokale (i pakuptimtë) pra kemi të bëjmë diku nga ajo që është planifikuar për 3-mujor është 68% realizimi pra nuk është aq sa është planifikuar. Mendoj se të të hyrat vetanake e kuptoj situatën në të cilën gjendemi pra gjendja është e komplikuar nga pandemia mirëpo megjithatë qeveria lokale duhet të gjej forma dhe metoda që të arkëtojë sa më shumë të hyra vetanake që së paku të kemi realizim aq sa është planifikuar sepse kjo është në interes të qytetarëve më shumë kuptohet, më shumë buxhet më shumë projekte dhe ndikon drejtpërdrejtë edhe në cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Te shpenzimet sipas kategorive ekonomike, te shpenzimet kapitale e kam vërejtur se vërtet aty shpenzimet janë bërë vetëm 14.7% dhe unë përsëri po mendoj se është kjo situatë por megjithatë duhet të punohet në atë mënyre që të gjithë ato projekte që janë planifikuar pastaj synimet që ja keni bërë vetes si qeveri me i realizuar sepse nëse shpenzimi është i vogël kjo është një tregues se nuk është punuar mjaftueshëm, kjo është një kërkesë sigurisht e imja si delegat, të shikohet të punohet në mënyrë periodike që të mos bëhet këtu në 3-mujor pak dhe pastaj ka fundi i vitit ndodh që të grumbullohen mjetet edhe të mos shfrytëzohen edhe bëhet edhe çrregullim edhe me projekte të ndryshme kur bëhen shumë.

**Dervish Çadraku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shumëçka u tha nga parafolësit me të cilët unë pajtohem edhe nuk po dua me i përsërit gjërat të cilat i kam vërejtur edhe unë, sigurisht edhe për shkak të situatës së jashtëzakonshme edhe mos me hije shumë në detaje por kjo është edhe përparësi e juaja sepse në këtë rast nuk kemi fol shumë pasi edhe nuk i keni realizuar, kushtimisht disa prej tyre, por unë do të filloja neper disa pika që veç të tjerët i thanë p.sh. në faqe 3, krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2013-2020. Këtu nuk i kemi të realizuara sepse viti 2019 është 246,957 euro ndërsa në vitin 2020 është 244,000 do të thotë kemi një minus 2464 euro. Pra krahasimi i të hyrave të rregullta, ju nuk keni pasur sukses në dy të hyrat prandaj ju nuk duhet të mburreni se keni punuar shumë p.sh. nëse shohim te nafta ju kryetar keni hargjuar naftë ju se sa inspektorët pra mbi 1700 euro prandaj edhe pse keni vrapuar shumë, disa gjëra nuk kanë dalë ashtu. Pastaj në faqe 4, te krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2019-2020. Këtu kam një vërejtje edhe pse pak foli z.Fazliu, është se keni një entuziazëm të madh menaxhmenti juaj edhe parashihni se do të keni të hyra të shumta pra keni vullnet ose ja keni huq në kuptimin e asaj që nuk ka përputhje në bazë të asaj që keni paraparë të hyrat dhe realizimi i të hyrave po ashtu. Pra është një shpërputhje ose drejtorët nuk po kanë shumë vëmendje për këtë, për projektet se çka do të realizohet brenda vitit ose diçka tjetër apo me siguri drejtori do të na shpjegojë apo ju kryetar p.sh. e kemi kodin 401110 kemi të planifikuara 541,000 euro ndërsa janë realizuar për 3 muaj 103,431 euro pra nëse këto i pjesëtojmë për muaj do të dilnin nga 30,812 euro për muaj dhe e shumëzojmë me 370,000 euro kështu që ja keni huq për këtë, hiq me pas se 170,000 euro d.m.th. nuk ka të hyra për vit nëse shkon dhe po më intereson se çka është ky 540,000, mos është edhe tatimi i tokës për të cilin nuk kemi filluar ende me zbatuar apo keni 540 herë e keni llogarit që me pas të

hyra në këtë kod. Po ashtu kemi edhe tatimin e taksës rrugore po ashtu kodi 50002 dhe 50001 taksa për demolim, po ashtu keni huqje 50013 d.m.th. te kodi 50002 taksa rrugore të realizuara janë 16,416 euro që i bien për muaj 5470 euro kurse të planifikuara janë 85,000 dhe dalin tash me një diferencë 20,000 euro dhe mos me hy ne detaje do ishte mirë me u përcaktua edhe me u përqendrua me tepër që të kemi një projektim më të saktë sepse nuk është serioze sipas mendimit tim. Ndërsa sa i takon kësaj pjesës tjetër të shpenzimeve, e thanë edhe të tjerët, me të vërtet mua nuk po më pëlqen kjo, për shpenzimet e ushqimit mirëpo kjo u sqarua edhe në mbledhje të KPF-së edhe sot u sqarua por nuk është në rregull në qoftëse psh kryetari i hargjon 1771 euro kurse inspekcioni i hargjon 772 euro dhe për këtë edhe del dikush e thotë se furrën e caktuar nuk e kanë përdor masat adekuate mbrojtëse sepse inspekcioni duhet me qenë pak me aktiv edhe mos me lejuar këto gjëra, kemi edhe shpenzime tjera por e mora këtë si bazë që duhet me pas shpenzime inspekcioni me shume se shumë të tjerë sepse inspekcioni është ai bilanci i mirëmbajtjes së këtyre rregullave.

**Kryetari** – Faleminderit shumë për kontributin në debat, më duket se ka një keqkuptim real të gjendjes së pandemisë dhe në çastin e diskutimit të cilët i dëgjoja me vëmendje, nuk është e çartë për një pjesë tonën si ekzekutiv edhe të anëtareve të kuvendit se çka në fakt është duke ndodhur. Ne me datën 15 mars të këtij viti, kemi pasur mbi 70,000 euro të hyra dhe nga data 15 mars deri me 31 mars nuk i kemi pasur as 15,000 dhe këtë duhet ta dini krejt ata që kanë diskutuar në këtë frymë po ju jap një përgjigje të qartë. Sot është data 30 prill dhe deri ditën e djeshme kemi vetëm 19,000 euro dhe këtë duhet ta dini që të gjithë. Pra, nëse jemi në thelbin e rrethanave dhe të realitetit konkret atëherë fryma e diskutimeve duhet të ketë këtë orientim edhe kam fakte dhe argumente që ilustron në çdo rrethanë. Unë nuk jam drejtor i Financave por jau sqaroj parimisht këtë dhe s'ka mundësi me ma demantua asnjë mekanizëm i verifikimit ose i kontrollit dhe as mekanizëm vendor apo ndërkombehtar, sepse kështu e ke në të gjitha komunat dhe jo vetëm në komunën e Rahovecit. Po ashtu, kështu e ke edhe në nivel qendror, ka taksa ATK-ja, të hyra nga doganat përveç furnitorëve dhe kështu që besoj që ska të hyra as në komunën tonë. E dini që ky kuvend po ashtu ka miratuar një vendim me propozimin e z.Hoxha dhe që jemi pajtue të gjithë që për 3 muaj të lirohen nga taksat qytetaret ose subjektet qofshin juridike ose fizike që kanë prona komunale me qira apo që kanë taksa në komunë, edhe ky është një argument që ndikon në zvogëlimin e të hyrave. Do të ju drejtohem juve si anëtarë të kuvendit me respekt, planin e prokurimit vjetor e kemi miratuar këtu por nuk jemi treguar shume të zgjuar sikurse nuk janë treguar edhe gjithë bota që ka me pas pandemi dhe me fillimin e procedurave të prokurimit besoj që tashmë e dini të gjithë se buxheti i Kosovës në Kuvendin e Kosovës është miratuar me datën 25 mars dhe nëse dikush mundet me thanë mua sot, se ne duhet të fillojmë procedurat e prokurimit pa miratim të buxhetit dhe pa miratim të planit të prokurimit nga KRPP-ja edhe me bo vepër penale edhe me më lutë dikush, unë nuk do ta bëj prandaj ka një keqkuptim të qartë edhe sa i takon zbatimit të planit vjetor të prokurimit që e kemi miratuar bashkë. Pra pandemia dhe vonesa e miratimit të buxhetit të Kosovës atje, jo vetëm në komunën tonë por në asnjë komunë nuk e ka lejuar me procedurë dhe me filluar procedurat e prokurimit dhe kjo është 100% e saktë. Për sa i takon shpenzimeve, ju besoj që ata që kanë diskutuar, po përpiqemi në frymën e diskutimeve me dhanë argumente dhe fakte. Zyra e kryetarit të Komunës, unë po ju siguroj se më shumë e kam përdorur kerrin privat pra temin se sa kerrin e kryetarit por në zyrën e kryetarit të komunës gjegjësisht kabinetin e kryetarit të komunës janë edhe dy xhipa po ashtu edhe 3 apo 4 makina tjera të cilat shpenzojnë në emër të kryetarit të komunës pra në kodin e zyrës së kryetarit të komunës dhe ata që merren me financa e din këtë. Për sa i takon drekave dhe darkave, besoni që unë nuk di përveç dikush nga stafi shëndetësor nëse ka pasur nevojë, ndoshta këta të IKSHP-së nëse ka pasur nevojë edhe prej zjarrfikëseve që gati një javë ditën edhe natën kanë fikur zjarre, asnjë drekë zyrtare nuk di assesi me mua dhe nuk besoj që janë bërë shpenzime të drekave zyrtare në këtë vite. Për sa i takon karburanteve, shpenzimet e karburanteve që ndoshta ju nuk e dini, shpenzimi i karburanteve ka rënë në çmim dhe ne kemi shfrytëzuar këtë rrethanë pra këtë momentum që të marrim furnizime për shkolla,

për krejt objektet sa më shumë në mënyrë që ta kemi çmimin ma të lirë. Por mos të harrojmë se kemi obligime të papaguara edhe nga viti i kaluar, prandaj kjo diskrepancë dhe kur bëhen krahasimet, unë besoj që këto detaje është ne gjendje me ja dhanë në secilën pikë drejtori i Financave Afrim Limani dhe ky e din ma mirë. Te gjykatat nga data 15 mars, gjykata në komunën e Rahovecit dhe të gjitha gjykatat në Republikën e Kosovës prej atyre themelore e deri te ato me të larta, vetëm gjykata kushtetuese me duket është duke punuar me siguri jo vazhdimisht, mirëpo proceset gjyqësore dhe trajtimet gjyqësore nuk kanë përgjigje për shkak se nuk punojnë gjykatat, të shumë rrethanave dhe marrëdhënieve që kanë në këtë rast palët me komunën e Rahovecit dhe nuk kemi tash të hyra nga gjykatat, për shkak se nuk punojnë. Kam kërkuar dy here me dezinfektua objektin e gjykatave edhe pse është dashur me dezinfektuar organet tjera nivelit qendrorë, por ne i kemi dezinfektuar objektin e gjykatës, objektin e qendrës së regjistrimit civil që është objekt i Ministrisë së Punëve të Brendshme edhe objektet të cilat nuk janë në pronësi tonën pra në shfrytëzim tonin, ne i kemi marr përsipër edhe i kemi dezinfektua. Këtë temë të diskutimit e kam pasur edhe me z. Kurti pastaj me z. Sfeqla, me zonjën Rexhepi edhe vizitat që i kemi pasur këtu. Pra ne kemi bërë një punë të mirë dhe ju kemi shërbyer edhe institucioneve qendrore për shkak se ndoshta ata nuk i kanë pasur mundësitë me i krye disa punë që janë të tyre edhe në Komunën tonë. Te lejet e ndërtimit- me kufizimet të cilat i ka ndërmarrë qeveria e Kosovës, ndërtimet kanë qenë të palejuara edhe vazhdojnë të jenë deri me datën 4 maj pra ndërtimet e larta, ndërtimet e ulëta, bile sektori i ndërtimit ka shumë anomali, është lejuar me u prodhuar betoni por nuk u lejua ndërtimi. Ne ju kemi tërhequr vërejtjen edhe si Asociacion i Komunave që këto anomali ose këto paradokse duhet të eliminohen sepse edhe nuk ke ku me dërgua atë beton. Legalizimi është një proces që ka filluar vitin e kaluar ndërsa ka vazhduar deri në janar, shkurt, mars pasi njerëzit kanë shprehur interesim me ardh me bo legalizimin edhe besoj që është një mundësi e mirë me ardh me realizuar sa më shumë të hyra. Te investimet kapitale siç e ngriti si çështje edhe z. Fazliu, z. Çadraku dhe z. Cena, tek investimet kapitale ne në disa pozicione kemi muajt me mbërrit me bo investime kapitale, projekte kapitale pasi kjo është varur edhe prej kompanisë dhe nga vjen ajo kompani p.sh. nëse ti ke pasur kompaninë nga komuna jonë dhe operon në komunën tonë, më lehtë ka qenë me dhënë leje të funksionimit por nëse ka ardhur nga ndonjë komunë tjetër pra Suhareka, Malisheva apo diku tjetër, kemi pasur vështirësi për dhënie e pëlqimit për me operuar në komunën tonë për shkak të masave të kufizimit. Tek borxhet, natyrisht se ne po hyjmë në obligime, Alia e ngriti këtë çështje, për shkak se kontrata kolektive po ju mundëson mësimdhënësve dhe po ashtu edhe këtyre që dalin në pension që janë në shërbimin civil që ne të detyrohemi në kuptimin e kompensimit të atyre që dalin në pension dhe madje mësimdhënësit dhe sindikata kanë deponuar argumentet e tyre edhe përmes avokateve, dhe uroj që kësaj problematike t'i jep zgjidhje Qeveria e Kosovës sepse ne do të ballafaqohemi sikur komuna e Prizrenit dhe komunat tjera, me siguri me qindra e mijëra euro që natyrisht ju takojnë atyre që dalin në pension e sidomos kategoria e mësimdhënësve. Për sa i takon subvencionimit të klubit të shkollave, ne ende nuk kemi filluar me i prek subvencionet sepse deri më tani nuk kemi pasur të drejtë edhe me i shpërnda subvencionet. Po e përsëris në Kuvend të Komunës para juve, ne nuk japim subvencione për veprimtari të cilat nuk ndodhin pra veprimtaritë kryesisht janë pezulluar apo janë ndaluar për momentin, edhe shkollat janë të ndaluara edhe pse mësimi online po aplikohet por ato janë të ndaluara fizikisht pra nuk kemi as nxënës e as mësimdhënës e as punëtorë teknik nëpër shkolla, po ashtu nuk kemi as nëpër klube sportive, as në Palestër dhe në plot aktivitete tjera. Prandaj ne do të përpiqemi që ta rikuperojmë planin e shpërndarjes së subvencioneve edhe të ju japim atyre që kanë nevojë dhe që mund ta justifikojmë me punë, me veprime konkrete dhe aktivitete konkrete marrjen e subvencioneve. Unë jam për me i mbështet klubet e recitatoreve, klubet artistike që krijohen neper shkolla tona, mund ta kemi një kategori të nxënësve apo mësimdhënësve që organizojnë aktivitete të tilla dhe që të mos i mbështesim por ato duhet të adresohen te drejtoria komunale e Arsimit, te zyra e kryetarit të Komunës. Tek realizimi i buxhetit- ka ndodhë në përputhje bile unë frikohem që mos i kemi tejkalua këto

kompetenca në kuptimin jo ligjor por kemi tejkalua kompetencat sepse kemi dhënë mundësi me punua njerëzit sidomos kompani që mund të operojnë tash për tash, edhe disa kompani ja kanë filluar punës pasi kanë kontrata, disa ende nuk ja kanë fillua për shkak të pengesave ose barrierave që ju imponohen nga situata pandemike. Tek të hyrat edhe njëherë po e përsëris pasi është planifikua bashke dhe ka marr aprovimin në kuvend plani i të hyrave. Unë jam i bindur që ne do të gjejmë modalitete me përmbush planin e të hyrave për këtë vite edhe përkundër faktit që këto 3 muaj janë jashtëzakonisht të vështirë edhe për tatimin në pronë edhe për taksa edhe për të hyra ne përgjithësi sepse gjendja momentale ju ka imponuar edhe shtetit tonë pra edhe komunës tonë rrjedhimisht, por nëse ju e shihni kurbën e të hyrave, ne kemi shkuar në ngritje në 3 muajt e parë dhe ju mund ta shihni dhe drejtori mund të ju jep saktë qysh ka rënë lakorja menjëherë zero, si ka qenë duke shkuar në ngritje menjëherë ka rënë posht për shkak se ska të hyra në komunë. Te pyjet po ashtu s'kemi pasur mundësi me marr të hyra, për shkak se dhe këtu është situata që lidhet me gjykata po ashtu edhe me Agjencionin Pyjor të Republikës së Kosovës. Mos harroni se komuna po punon me stafe pak me të gjërë pasi në institucionet qendrore shume pak ka njerëz që punojnë në institucionet publike pra shërbime civile. Ne kemi vështirësi tepër serioze me i implementue kërkesat që i ka niveli qendrorë për nivelin komunal, po ju jap si shembull pakoja 15, i jepet mundësi komunave në këtë rast qendrës për punë sociale për me aplikua qytetaret të cilët konsideroj që kanë të drejtë me aplikua ose me përfitua nga masa 15, njëkohësisht edhe enti i punësimit është i ndërlidhur me këtë proces dhe anomalia është këtu pasi enti i punësimit nuk punon hiq dhe gjithë njerëz që shkojnë aty, bëhen grumbull edhe ne kemi reagua edhe ate seriozisht edhe si komunë edhe me zgjidhë këtë si problem. Pra ne implementojmë edhe situata të cilat prodhohen nga niveli qendror dhe për shkak se niveli lokal e ka mundësinë tani dhe ne masën 15 të gjithë po aplikojnë edhe ata që kanë asistencë sociale, edhe ata që nuk janë në marrëdhënie pune edhe ata që janë largua prej pune nga bizneset në këtë kohë edhe bizneset të cilat ju ka ndërpre veprimtaria në këtë kohë, kështu që unë besoj që ata do të jen përfitues në bazë të shumave dhe shpresoj që pakoja fiskale do të ndryshojë në kuptimin pozitiv, pasi ka propozime të ndryshme edhe të partive të ndryshme dhe besoj që do të na merr një rritje do të zgjerohet. Pra ne kemi kërkuar që tash fermerët me i futë në pakon mbështetëse edhe ju kemi adresua edhe z. Kurti edhe z. Mustafa, besoj që nëse e meriton dikush mbështetjen, ata janë fermerët të cilët kanë pasur pengesa në plotë plane sepse me djersë pse mos të përfshihen edhe fermerët e komunës se Rahovecit ose fermerët e Republikës se Kosovës në kategorinë e mbështetjes në kushte pandemie. Unë e di që tash kur të bëhen raportet 3 mujore që i prezantoj Afrim Limani, ka kontradikta midis asaj qa kemi planifikua dhe që kemi marr miratimin në Kuvendë dhe asaj që po ndodhë në terren, për shkak se është situata me Pandemi dhe asnjë argument tjetër nuk ka sepse po të kishim ne sot do të kishim raportua për rritje të hyrave kështu që kjo është paqartësia . Sa i takon situatës nga pandemia, sot janë marrë 10 mostra nga IKSHP-ja nga familjaret raste kontakti në Reti edhe raste kontakti në qytete, shpresojmë që të na dalin negativ edhe gjendja shëndetësore përveç e njërit pacientë vazhdon të jetë stabile dhe e qetë përveç pacientit që është në kliniken infektive.

**Kryesuesi - Faleminderit shume kryetar, tani kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:**

### **3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2018-2019 në vitin 2020.**

**Afrim Limani –** Përhëndetje të nderuar asamblistë, siç jeni në dijeni ky kuvendë ka fundi i muajit janar ,inkasimi i të hyrave vetanake që shume e atyre të hyrave ka qenë mbi 200 000 euro mirëpo tash që kemi një shumë të konsiderueshme të mjeteve që duhet ti bartim nga viti 2019 në vitin 2020 kryesisht janë mjete të cilat janë inkasuar nga të hyrat vetanake gjatë muajit dhjetor dhe një pjesë në muajin Nëntor, për shkak të mbylljes se Semit të cilat mjete të cilat nuk kanë mundur të implementohen në projekte të caktuara gjithashtu janë hyra nuk kanë mundur me u realizua në projekte të caktuara. Shuma e përgjithshme për bartjen e të hyrave në total është 231 776 euro dhe këto mjete janë kryesisht në pozicionin e pagave dhe mëditjeve, në kuadër të shëndetësisë janë 21 926 euro, për mallra dhe shërbime 350 euro ndërsa për investime kapitale janë 210 000

euro. Kryesisht në investime kapitale i kemi bartë këto mjete te ato projekte të cilat ju ka skadue kontrata dhe mjete të cilat kanë mbetur të pa zotuar dhe ato i kemi te ajo pjese e borgjeve. Pra janë disa projekte të cilat janë në kuadër të drejtorisë se shërbimeve publike, drejtorisë se urbanizmit. Ne administratë etj. Te nderuar asambleistë, pres nga ju që ta votoni, pasi realisht këto mjete janë planifikuar një pjesë për paga dhe mëditje nga të hyrat vetanake në shëndetësi konkretisht te stafi mjekësor të cilët kanë punuar me orar shtesë edhe këto mjete që dy vite janë duke u bartur, në vitin 2019 këto nuk janë shpenzua sepse këtë shpenzim e kemi mbuluar nga kategoria e pagave dhe mëditjeve nga pozicioni dhjetë nga buxheti nga grand i përgjithshëm, atëherë sipas ligjeve në fuqi që janë pjesa e pambuluar e këtyre mjeteve duhet të alokohet pikërisht në këto. Atëherë ne duhet patjetër që ti bartim këto mjete në kuadër të pozicionit paga dhe mëditje, pasi një pjesë e pambuluar në mallra dhe shërbime prej 850 euro ndërsa pjesa tjetër për investime kapitale janë 210 000 euro.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderojmë drejtorin për sqarimet që na dha edhe në KPF e thamë që e kemi trajtuar këtë, edhe ashtu që kjo shumë prej 232,000 euro nuk është edhe shumë e madhe që do të na kishte ndihmuar në buxhet edhe krejt projektet qa i kemi nuk mundemi me i realizuar por esenca është që a ka mundur që këto pak mjete që janë me u iniciuar në çështje tjera p.sh. në ndonjë projekt tjetër por edhe ju si qeveri komunale kështu e keni paraparë ju, dhe ju e dini ma mirë këtë, kështu që nuk po e zgjatim shumë që me propozua projekte tjera, kështu e keni paraparë dhe kështu le të mbetet, mirëpo kemi mjaft gjëra që më të vërtetë kanë mbetur anash që shumë vite edhe nuk kanë zgjidh edhe nuk kanë vend me hy në punën e zgjidhjes, por thash edhe me herët se më 200,000 euro nuk mundesh me i zgjidh ato probleme kështu që po pajtohem se qysh i keni paraparë ju edhe le të bëhet bartja e këtyre mjeteve edhe vazhdojmë më tutje.

**Kryesuesi** – Faleminderit shume z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P-02279/0, 02280/0 dhe 02281/0.**

**Përparim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtare të kuvendit komunal. Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politike dhe Financa e kemi diskutuar këtë pike te rendit të ditës, ku ne si drejtori e shërbimeve publike kemi propozua të hedhet në ankande parcela, me detalisht do të ju njoftoj parcela ka të bëj me pjesën ku do të hidhen mbeturinat inerte. Në vitin 2019 ky kuvendë ka nxjerrë këtë parcelë, ku do të përcaktohet për hedhjen e mbeturinave dhe mbetjeve inerte. Fjala është për 3 parcela me një madhësi prej 10 hektarësh, ku përmes komisionit të ankandit publik, ky kuvendë është mirë që paraprakisht ndoshta këtu do të më ndihmojnë edhe zyrtaret ligjorë këtu që janë prezentë, paraprakisht do të përcaktojmë edhe një tarifë që do të i bashkëngjitet ankandit publik. Në momentin që kompania e specializuar merret merr përsipër këtë parcelë, në bazë të tarifës që e përcakton kuvendi komunal do të fillon edhe mirëmbajtjen e atij deponimi. Tash për fillim nëse dikush ka ndonjë pyetje, ne do të jemi këtu të i përgjigjemi.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin, për mua kjo është pikë shumë e rëndësishme dhe vërtet ndër vite kemi telashe në hedhjen e mbeturinave të ngurta inerte kështu që kjo do të ishte një zgjidhje shumë e mirë për komunën e Rahovecit sepse me këtë rast do ta mbronin edhe mjedisin tonë pra ambientin në përgjithësi dhe uroj që në këtë projekt të konkurrojë një person i përgjegjshëm që vërtet i kryen detyrat ashtu siç duhet përmes ankandit publik kur të bëhet, edhe të mbaj rendin edhe rregullin ashtu siç duhet, e për çmim që tha drejtori ndoshta është deshtë edhe me paraparë se edhe ne vijmë me një propozim edhe unë mendoj se çmimi duhet me qenë i arsyeshëm, simbolik dhe normalisht që i plotëson nevojat aty, pasi ka plot detyra që duhet me rrethuar terrenin edhe me gjelbërua pak, pastaj me mbjell drunjtë edhe me rregulluar siç duhet aty terrenin. Këtu janë 3 parcela, njëra parcelë që e pash edhe nuk ishte e cekur aty se cilës klasë i takon, kurse këto dy tjerat ishin të klasës 5 siç e pashë kurse parcela 2.2 nuk ka, me siguri edhe kjo është e klasës 5-të

mirëpo veç thash se është mirë me qenë pasi është dokument me qitë edhe klasën e kësaj parcele aty. Jemi dakord pra për këtë dhe është mirë tash te vendosim për punë të çmimit por sigurisht çmimi të jetë real dhe i përballueshëm edhe për ata që i bien aty mbeturinat, pasi nëse jemi shumë të shtrenjtë atëherë njerëzit hezitojnë me qua aty edhe i gjuajnë në mjedise të caktuara dhe prapë mjedisi do të jetë i ndotur.

**Fehmi Cena** – Faleminderit kryesues, edhe unë mendoj se atë mundemi me kuptua në bazë të këtij draft vendimi, deponia inerte që është në periferi të qytetit do ta merr një status tjetër të veçantë që do të jetë në mbikëqyrje. Mendoj se ne si delegatë duhet ta përkrahim se është në interesin e komunës dhe të qytetareve. Natyrisht edhe unë kam brengën e njëjtë sikurse z. Fazliu që kur do të bëhet caktimi i çmimeve për hedhjen e mbeturinave, duhet të jemi të kujdesshëm që çmimi të jetë sa më i arsyeshëm që në të kundërtën mos të ndodhë që qytetaret të hedhin mbeturinat vend e pa vend sikurse që ka ndodhur edhe më herët.

**Dervish Çadraku** – Edhe unë po jap kontribut në këtë drejtim edhe po them që ky lokacion që do të lëshohet për mbeturina inerte, kisha thënë që të mos bëhet pagesa për një vit që ne qytetaret e kemi parë kemi përgjatë rrugëve, lumit apo vendeve ku e frekuentojnë njerëzit plot mbeturina, e ndoshta do ishte mirë që për një vit të mbetet pa pagesë dhe qytetaret që i bien mbeturinat të mos paguajnë për një vite p.sh. qytetaret me ardh prej Malësisë se Vogël, boll i bien shpenzimi deri te deponia, deri sa të krijohet edukata që duhet me dërgua mbeturinat aty, se veç me shkua përgjatë Drinit nga Gexhë e deri në Çifllak është një zonë e tmerrshme pasi ka shumë mbeturina, kështu që me mujt që komuna me marr përsipër këtë punë që fillimisht grumbullimi të bëhet pa pagesë.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit shumë, sinqerisht po më pëlqen ky propozim dhe është shumë mirë që më në fund që komuna do ta ketë dhe do ta funksionalizojë deponinë për mbetje inerte. Këtu në këtë aspekt më së shumti mundet me na lehtësuar edhe neve kuvendareve shefi i zyrës ligjore. Po ashtu po me pëlqen edhe propozimi i kuvendarit z. Çadraku që të paktën një vit mos me pagua qytetaret që i bartin mirëpo në këtë rast kur të shpallet në ankand edhe e merr dikush me menaxhuar, sigurisht edhe ai duhet me pas ndonjë interes që e menaxhon atë sepse me pagua qera apo mos me pagua qera, gjithsesi inkasimin duhet më bo dhe në këtë rast nëse bohet për një vite, komuna duhet me marr përsipër që disa lehtësira për operatorin që e merr në menaxhim këtë deponi inerte. Tash duhet me bo edhe një statistike ose parallogari paraprake që duhet me i ndihmua atij që e merr. Unë të drejtën me ju thënë ja kisha dhënë falas atij nëse kemi të drejtë pra kisha propozua që me marr një vendim me ja dhënë falas por vetëm le ta menaxhon ashtu si duhet cilido që është.

**Isak Hoti** – Përshëndetje kryesues, kryetar dhe ju delegatë të nderuar. Atëherë ky kuvend ka nxjerrë një vendim fillimisht për caktimin e lokacionit për mbeturinat inerte. Pas këtij vendimi jemi të obliguar të nxjerrim një vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone. Dallimi është se vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim, komuna do të inkasoj mjete prej pronës që japim me qira ndërsa është edhe një vendim tjetër që duhet me nxjerr për caktimin e tarifës për mbeturina inerte për metër kub. Në bazë të praktikave që i kanë nxjerr 2 apo 3 komuna dhe ne jemi komuna e katërt që kemi fillua me nxjerr, edhe ata e kanë caktuar 0.50 cent për metër kub privat që i qojnë mbeturinat inerte në lokacionin ku e kemi caktuar ne. Operatori i cili e fiton në bazë të ankandit dhe kriterëve që do të përcaktohen në ankandin publik, operatori do të i paguaj komunës qiranë në bazë të asaj që komisioni për vlerësimin e ofertave që ka me i përcaktua kriteret dhe sa është çmimi i pronës që ja japim në shfrytëzim operatorit ekonomik i cili e fiton. Pra sot jemi të obliguar që patjetër me nxjerr një vendim për caktimin e tarifës për mbeturina për metër kub për mbetje inerte. Vendimi paraprak nuk është komplet mbi bazën e ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paligjshme komunale, për shkak se ligji për mbeturina neni 40,e përcakton formën në të cilën jepet në shfrytëzim kjo parcelë edhe udhëzimi administrativ përkatësisht neni 18 i Ministrisë së Planifikimit hapësinorë 07/2015. Maksimumi i kësaj që mundemi me dhanë në shfrytëzim është 5 vjet pra nuk mundemi me dhanë më gjatë. Këtu po besoj që jam i qartë pasi dy vendime nxirren në këtë kuvend, pra draft vendimi për dhënien në

shfrytëzim që keni përpara edhe vendimi për caktimin e tarifës. Unë ju kisha lexuar shume shkurt se çka do të përmban vendimi i cili do të nxirret për caktimin e tarifës. Përveç preambulës është edhe ligji për dhënien në shfrytëzim e këmbim, ligji për mbeturina dhe udhëzimin administrativ që e përmendem më lartë. Te pika 1 do të dojmë kështu: me këtë vendim caktohet tarifa në vlerë për këtë shumë.... për metër kub për deponinë e mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore në lokacionin që e ka përcaktuar komuna e Rahovecit. Pastaj pika 2, se kush është i obliguar dhe pika e 3 që i drejtohet MAPL-së. PR janë pika të shkurta sepse këto tarifa nuk e kemi të caktuar në rregulloren për taksa tarifa dhe ngarkesa e gjoba sepse është iniciative e re nga drejtoria e shërbimeve publike.

**Kryetari** – unë e dëgjova me vëmendje propozimin e Dervish Çadrakut që me njëfarë mënyre u pajtua edhe z. Fehmi Hoxha. Këtu dy rrugë janë. që ne me pagua operatorin për me mirëmbajtje që është shumë e vështirë edhe që është deponi e madhe ose ne duhet me ja dhënë mundësinë operatorit fitues, kuptohet që ta mirëmbaj deponinë duke vjelur të hyra që vinë aty subjektet, operatorët, individët dhe bien mbeturina inerte. Deponia është legale pasi ne kemi ndërmarrë edhe publikisht e falënderoj Mendi-P, që e ka pastrua vullnetarisht pasi aty ka qenë një vend thuajse i shkatërruar, që kishte filluar edhe me i dëmtua edhe vreshtat e prona private, prandaj ne kemi ndërmarrë një masë urgjente për me pastrua vullnetarisht edhe e ka pastruar. Ne kemi angazhuar një roje tani për tani që e ruan atë deponi dhe nuk është që merr ndonjë pagesë por vetëm e ruan edhe i orienton për me i dërguar atje në gropë. Nuk guxojmë me u vonuar edhe nuk kemi arsye me lënë për një vit pasi është e vështirë me funksionuar në të gjitha fshatrat por ne do të kujdesemi që ndoshta në kriteret e ankandit komisioni ta vendos po supozojmë në Malësi të vogël apo Ratkoc apo në Kramovik edhe me i deponua diku përkohësisht pastaj në mënyrë që operatori me pas të drejtën apo mundësinë me i qua në deponinë legale. që mund të bëjmë një zgjidhje kalimtare. Për sa i takon tarifës, është e vërtetë që nëse komunat tjera e kanë një vlerë, atëherë ne mund ta caktojmë një vlerë. Afati i kontratës është 5 vjet që me siguri ligji për menaxhimin e mbeturinave e parashihet ashtu, pasi me lan me shumë se 10 vjet atëherë ajo mbushet. Me siguri koha kufizuar është precizuar me ligjin për mbeturina për shkak se edhe bjen në kundërtënie me ligjin për dhënie në shfrytëzim, kështu që unë besoj edhe është e qartë edhe kuvendi ka mundësi me dhanë një propozim për tarifë, që këto komunat e kanë 0.50 cent apo ne mundemi me dhanë një tarifë si p.sh. 0.40 apo 0.30 cent edhe e formulojmë vendimin duke u bazuar edhe në ligjin për dhënien në shfrytëzim edhe në ligjin për menaxhimin e mbeturinave edhe në vendimin për caktimin e tarifës, natyrisht edhe përmes ankandit publik edhe komisionit për përcaktimin e kriterit për vlerësimin e ofertave me u përcaktua saktësisht se çka jemi duke bërë. Besoj që Kuvendi ka mundësi sot me ndez dritën jeshile edhe ne me vazhdua sa ma shpejt, për shkak se duhet me u ballafaqua me një situatë edhe unë duhet me ardh me ju raportua juve edhe me ju tregua se qysh janë hargjuar p.sh. ja 5 apo 6 mijë euro për një pastrim e që pas tri dite mbushet prapë, pasi ne rojën nuk mund ta lejmë për shume muaj aty por e kemi lanë për këtë muaj deri sa të i bëjmë një zgjidhje të menaxhimit të asaj deponie legale. Unë ju ftoj që ta votojmë me një formulim të qartë pa ekuivokë të vendimit të përcaktimit të tarifave p.sh. që unë propozoj që nëse Suhareka e ka 0.50 cent për metër kub atëherë ne mund ta lemë 0.40 cent për metër kub por përsëri mundemi me u mbledhë edhe me vendos ndryshe në ndonjë seancë tjetër por tani e lejmë me 0.40 cent për metër kub ose ne rregullore kur të vjen, ne mundemi me ndryshua, pasi rregullorja ka me u miratua në seancën e Majit, që po besoj që do të miratohet pasi m varet edhe prej juve, nuk kemi guxuar me shtie në debat publik për shkak të pandemisë sepse në këtë seancë do ishte miratuar edhe deri në Maj nuk kryhet ankandi nuk ka mundësi për shkak se janë procedurat edhe po ma merr mendja që mund ta kemi një orientim sot p.sh. 0.40 cent pra 0.10 cent me lire se sa komunat tjera që e kanë edhe nuk ka të keqe asgjë edhe të fillojmë të ecim me tutje. E kuptoj shqetësimin e Rasimit, me plotë të drejtë por ne nuk e kemi miratuar ende rregulloren për taksa tarifa gjoba dhe ngarkesa, për shkak se është një iniciativë e re dhe ju e dini në Kuvend të Komunës ka filluar me z. Vehapi deponia pastaj u legalizua në kohën e qeverisjes tonë,

është marrë vendimi vitin e kaluar këtu edhe tash rregullorja është me hershme prej 2017 në fuqi kështu që besoj që e përfshin edhe në rregullore tarifën e përcaktuar për operatorët që derdhin apo i dërgojnë materialet inerte në deponinë legale. Unë ju kisha ftuar me votu edhe besoj që qartësia ekziston pasi na kushton shume vonesa nëse e lëmë në një seancë tjetër.

**Dervish Çadraku** – Kryetar, ju e theksuat edhe vetë që ndoshta është mirë me pas deponia ndihmëse ndoshta 3 në komunën tone pos kësaj qendrore këtu, njëra me qenë ka pjesa e Kramovikut, njëra ka pjesa e Optrushes dhe tjetra ka pjesa e Krushes. Kështu që në njëfarë mënyre jemi të barabartë pastaj te pagesat sepse për 0.10 cent nuk është asnjë problem, kështu që nëse e bien ai prej Kramovikut atij ja mundëson me qenë i barabarte me këta këtu kështu edhe çmimi nuk ndryshon pasi edhe ai me pas mundësi me hedhë atë mbeturinë atje dhe pastaj shpenzimet shtesë i ka ai operator për këto tjerat, edhe është me lehtë për qytetarin sigurisht edhe për neve d.m.th. është e pranueshme për me funksionua me lehtë.

**Kryetari** – Faleminderit z. Çadraku, unë po e formuloj kështu, a jemi dakord ne me konkludua që po e nxjerrim një vendim për caktimin e tarifës 0.40 cent për metër kub dhe në kriteret që i harton komisioni për ankande, të jep mundësi për krijimin e mekanizmave apo deponive ndihmëse dhe të përkohshme kuptohet dhe e ftojë drejtorinë e Shërbimeve Publike, inspektoratin e Zyrës Ligjore që ta fusin edhe këtë në mënyrë që të krijohet e ashtuquajtura barazi që ka nevojë për shkak se distancat janë të mëdhaja dhe ndoshta më mirë e menaxhojmë këtë këtu edhe më mirë i menaxhojmë mbeturinat inerte edhe nëpër lokalitete tjera. A jeni dakord ju që në kuadër të këtij vendimi për 5 vjet të jepet në shfrytëzim ose në menaxhim deponia siç e përmendi shefi i Zyrës Ligjore Isak Hoti, dhe po ashtu a jeni dakord që ne, nëse marrim këtë vendim këtu ta fusim tarifën edhe ne rregulloren për taksa dhe tarifa, në mënyrë që mos të kemi nevojë pastaj me ndryshua. Unë jam për 0.40 cent dhe jam për me i krijuar këto deponitë ndihmëse që janë të përkohshme dhe jam për 5 vjet me ju dhanë në shfrytëzim dhe sigurisht që jam që kriteret e ankandit nga komisioni që është edhe nga përbërja e kuvendit vërtet mu kujdes edhe mu adresua këto shqetësimet të cilat i kemi edhe si ekzekutiv edhe si Kuvend. Nëse jeni dakord kështu në këtë mënyrë atëherë formulimin e bëjmë. Unë po them që përmes inspektoratit, ata që dojnë me deponua mbeturina inerte diku dhe s'kanë ku t'i deponojnë sepse është largët atëherë ne me ndihmën e inspektoratit mund t'i gjejmë një vend të caktuar me i deponua dhe pastaj pas dy dite me ardhë me i marr dikush, në këtë kuptim e kisha unë pasi edhe nuk jemi në fazën për me marr pëlqime sepse ende nuk i dimë se ku janë ato vende saktësisht lokacioni ku pretendohet të krijohen dhe ne vetëm kështu praktikisht me ndodh kjo por me kusht që operatori pas dy dite me shkua me i trajtua ato stoqe që krijohen për 3-4 dit apo një javë dhe normalisht e merr obligim me i largua prej aty dhe me i trajtua ate pozicion të përkohshëm dhe me i dërgua ne deponi inerte sepse për me ardh deri të deponitë tjera legale mundet me shkua edhe 6 muaj apo 1 vite, për shkak se duhet ekspertizë, vendime të kuvendit, certifikim nga Ministria e Planifikimit edhe Mjedisit kështu që janë standarde që ne nuk mundemi me i aplikua tani për tani legalisht por praktikisht mund te i kryejmë. Nëse ankandi i thotë në territorin administrativ kriteret e ankandit thonë nuk dëshirojmë me pa mbeturina inerte në asnjë lokacion të Komunës tonë përveç ne lokacionin atje atëherë ne mundemi me shtie si adutë shtesë aty që ai që e merr në shfrytëzim edhe e din si ta menaxhojë. Është paksa problem si me menaxhua por unë kam një vetëbesim se mundemi me i shtua kapacitetet dhe mundemi me menaxhua ma mirë se sa është tani por këtë ta lëmë në proces sepse ne nuk kemi dëshirë mos me pas mbeturina ne Drenoc, Rahovec edhe këto pjesë tjera që janë afër deponisë edhe me u mbush me mbeturina që nga Mrasori e deri në Krushë të Madhe edhe këtë pjesën tjetër deri në Optrushë. Prandaj ne duhet ta bëjmë një zgjidhje edhe po shpresojmë me bo bashkë por unë jam për me i dhënë dakordim për 5 vjet menaxhim, kriteret të forta të ankandit, tarifa të jetë 0.40 cent për metër kub. Pra vullneti dhe angazhimi i të gjithëve është mos me pas mbeturina inerte përkaj Drinit të Bardhë, parqeve apo rrugëve, për shkak se kemi një deponi e cila llogaritet që për 10 vjet mundet me përballua krejt mbeturinat inerte që mund t'i prodhoj komuna e Rahovecit. Por

ndërkohë të vazhdoj punën për deponi tjera sepse është procedurë komplekse dhe kërkohen standarde, pëlqime, ekspertizë dhe ne ato nuk i kemi tani për tani, e ta krijojmë bile këtë çka e kemi.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit shume kryesues, patjetër që jam pro kësaj mirëpo mos po biem ndesh me ligjin qysh tash pasi shefi i Zyrës Ligjore tha që duhet me marr një vendim për caktimin e tarifës. Në rendin e ditës të cilën e kemi miratuar në fillim, nuk figuron fare marrja e vendimit për caktimin e tarifës. Ligjërisht duhet me u marr ky vendim, ndoshta tani duhet ta qesim edhe ta votojmë se ky dokument duhet me u certifikua në MAPL dhe nuk e di qysh do të certifikohet kur në rend ditës fare nuk është dhe duhet me u marr vendim, pasi mire e ka shefi i Zyrës Ligjore që këtu duhet me u marr vendim për me caktua tarifën. Kryetari nuk mundet me u inkorporua kjo ligjërisht assesi në rregulloren e cila është në diskutim në shqyrtim publik. Por në vitin tjetër mund të inkorporohet kjo tarifë për grumbullimin e mbeturinave në kuadër të rregullores, tash ligjërisht nuk kemi mundësi, mirëpo kjo nuk na prish punë dhe vitin tjetër e inkorporojmë. Duhet të merret vendim mirëpo paraprakisht duhet të qitet në rend të ditës edhe këtë pikë se duhet me u certifikua në MAPL kjo. Nuk është në rend dite kurse ne po duam me marr një vendim. Unë po frikohem se mos po gabojmë, nuk po dua me polemizua këtu dhe ma merr mendja se kështu duhet të veprhet.

**Munib Durguti** – Faleminderit kryesues, ngjashëm me parafolësin, unë kam hallin e bazës ligjore të çmimorja. Unë besoj që vendimi do të kthehet prej Ministrisë për arsye se nuk kemi një bazë ligjore për me caktua tarifa. Kryetari e propozojë një tarifë, parimisht është e pranueshme prej të gjithë neve por baza ligjore për një tarifë mungon në komunën tonë dhe ne nuk mund të themi se bazohemi në x komunën që e kanë një tarifë të ngjashme sepse ato komuna me siguri e kanë të aprovuar rregulloren për taksa tarifa gjoba dhe ngarkesa. Nëse ka mundësi që puna e çmimore të shtyhet derri ne aprovimin e rregullores do ishte shume ma mirë ndërsa sot marrim ne një vendim siç është ardh me rend dite ndërsa çmimi caktohet në një seancë tjetër, menjëherë në seancën e radhës vjen rregullorja për aprovim dhe menjëherë pas rregullores aprovohet edhe çmimi që do të del prej diskutimit.

**Sali Sallteku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Unë po e them se këtë çka e ka bo kryetari po me pëlqen shume dhe është shume me vend edhe ato tjerat si ndihmëse do jen shume mirë, e për gjëra tjera që do vine mandej sepse tani për tani është shume problem me prua prej Kramovikut edhe falë me lan nuk e bien, por ne duhet ta bëjmë pasi vërtet është një propozim shume i mirë dhe shume me vend. Tani nuk duhet të diskutojmë për gjëra ndoshta ndërkohe kanë me u rregullua kur ne aspektin ligjor i rregullojmë edhe të shkojmë në veprim që ta qesim ne votim edhe kryejmë.

**Isak Hoti** – Atëherë Munibi e përmendi çështjen e bazës ligjore, absolutisht që ky kuvend është ai që i përcakton taksat dhe ky kuvend është që i rregullon edhe çështje tjera me një akt të veçantë pos rregullores për çështje të ndryshme. Në këtë rast si praktike është ndjekë në të gjitha komunat që tarifa për mbeturina inerte të përcakton kuvendi me një vendim të veçantë edhe për këto kemi edhe ligjshmërinë e akteve që i ka nxjerr MAPL-ja të komunave tjera. Këtë nuk po e themi përmendsh pasi ligjërisht jemi mirë edhe unë jam shume i sigurt edhe i bindur se MAPL-ja ka me certifikua këtë vendim. Krejt çka duhet është ju me votua këtë vendim edhe unë kam bindjen e plotë se kemi me hecë që mos të vonohemi.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, unë pajtohem me z. Sali Sallteku që e tha se kryetari i tha të gjitha këto edhe po shkojmë përpara por thjesht kryetari e qartësoj situatën aty mirë por e vërteta më mirë do ishte të ishim ardhë të përgatitur për këtë mbledhje sepse jemi të përgatitur, nuk diskutohet kjo por meqenëse po thoni që duhet të përshpejtojmë punën, unë po propozoj që të shkojmë në 0.40 cent për metër kub të mbeturinave të ngurta edhe fati kohor për 5 vite meqenëse ligji po e parashikon ashtu.

**Mirsad Shala** – I nderuari kryetari i Komunës, Kryesues dhe gjithë ju të pranishëm. Komuna e Rahovecit në vendimin e Kuvendit të komunës Nr.19/70 të datës 08.06.2018 ka miratuar planin strategjik të veprimit kundër korrupsionit 2018-2021, i cili është dokument strategjik që tregon përkushtimin e Komunës në përmirësimin e

vazhdueshëm të kontrolleve ekzistuese në luftë kundër korrupsionit. Ky plan ka për qëllim rritjen e mundësive organizative për reduktimin dhe eliminimin e mundësive për korrupsion si dhe forcimin e rezistencës ndaj shkeljeve eventuale korruptive në Komunën e Rahovecit si dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës në sistemin e menaxhimit të komunës. Prandaj duke u bazuar në këtë planë, në të cilën përcaktohet përgjegjësia dhe autoriteti për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit kundër korrupsionit. Me vendim të kryetarit të komunës Nr.02/22720 të datës 20.01.2020 është caktuar zyrtari përgjegjës për mbikëqyrje e zbatimit të planit të veprimit kundër korrupsionit 2018-2021. Të nderuar kuvendarë, para jush e kemi informatën e detajuar në lidhje me zbatimin e planit nga drejtoritë, sektorët dhe kabineti i kryetarit të Komunës në të cilën janë të përshkruar masat që janë ndërmarrë nga drejtoritë dhe kabineti i Kryetarit të Komunës në lidhje me luftën kundër korrupsionit, e cila informatë gjithashtu është e publikuar edhe në web-faqen zyrtare të Komunës. Unë shkurtimisht do të përmend, nëse jeni dakord disa direktiva dhe masa të cilat janë ndërmarrë nga ekzekutivi komunal për zbatimin e këtij plani. Planet komunale strategjike, planet buxhetore dhe hartimi i rregulloreve të ndryshme të cilat janë me rëndësi për komunën e Rahovecit u mundësohet pjesëmarrja e qytetareve përmes njoftimeve për mbajtjen e debateve publike me anë të cilëve qytetaret informohen me kohë për të gjitha çështjet strategjike komunale. Në mënyrë që transparenca dhe llogaridhënia të jenë të hapura, web-faqja komunale përditësohet me informata përkatëse ditore lidhur me politikat dhe arritjet e komunës. Duke pasur parasysh angazhimin e plotë kundër korrupsionit gjithashtu është rritur niveli i bashkëpunimit me asociacionin e komunave të Kosovës, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe agjencinë kundër korrupsionit ku komuna e Rahovecit e ka të caktuar edhe zyrtarin përgjegjës i cili mbanë kontakte të rregullta me institucionin të komunës dhe AKP-së. Masë tjetër e ndërmarrë nga Kryetari i komunës e cila ka të bëjë me planin strategjik kundër korrupsionit është se me vendim të veçantë është caktuar edhe zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve e cila është paraparë në ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve për vitin 2019. Vlen të theksohet se Komuna e Rahovecit për vitin 2019 të cilës i referohem nuk ka asnjë rast të lajmëruar për korrupsion, gjë që duhet të mbetet edhe synim i qeverisë komunale të vazhdohet edhe në të ardhmen me transparençën dhe luftimin e korrupsionit. Një masë tjetër e cila vlen të përmendet për luftimin e korrupsionit është se Komuna e ka linjën e sigurt telefonike, ku shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit mund të lajmërojnë rastet eventuale. Kjo linjë telefonike është pa pagesë për qytetaret e Komunës së Rahovecit. Të gjitha vendimet të cilat merren nga kryetari i Komunës publikohen menjëherë në webfaqen elektronike të komunës. gjë që e rrit transparençën e llogaridhënien ndaj qytetareve të Komunës. Mbledhjet e Kuvendit komunal gjithashtu transmetohen drejtpërdrejt dhe janë të hapura për publikun pasi Komuna e ka të kontraktuar median lokale e cila e bën transmetimin e drejtpërdrejt të mbledhjeve. Vlen të theksohet në mënyrë që transparenca dhe llogaridhënia të jetë në nivelin e kërkuar nga Ministrinë dhe OJQ-të qeveritare dhe ato joqeveritare që janë që bëjnë monitorimin e Komunës në vazhdimësi janë duke publikuar vendimet të cilat nënshkruhen nga Kryetari i Komunës. Në vazhdimësi janë publikuar edhe draft planet e ndryshme dhe pas miratimit të Kuvendit Komunal dhe marrjes së ligjshmërisë nga ana e Ministrisë të njëjtat janë publikuar në web-faqen zyrtare të Komunës ashtu si parashihet. Komuna e Rahovecit vazhdon të vlerësohet pozitivisht në pjesën e transparencës dhe llogarisë. Në këtë drejtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Komuna e Rahovecit është vlerësuar me vendin e parë si më transparentja në mesin e 38 komunave në nivele vendi. Vlerësim pozitiv ka marr edhe nga KDI, OJQ-të etj. që bëjnë monitorimin e Komunës gjatë gjithë vitit. Të nderuar kuvendarë, si përfundim jemi të vetëdijshëm se lufta kundër korrupsionit është detyra jonë ligjore, është zotimi ynë publik dhe obligim i secilit qytetar të Komunës tonë. Komuna e Rahovecit vazhdon të jetë e përkushtuar në luftën kundër Korrupsionit dhe respektimin e sundimit të ligjit në mbarë territorin e Komunës së Rahovecit. Përpjekja jonë për zbatimin e planit strategjik komunal për luftimin e korrupsionit do të jetë me e përqendruar, me dinamike dhe gjithëpërfshirëse. Andaj ju inkurajoj të jemi të hapur që bashkërisht dhe pa

asnjë ngurrim, te gjitha pa dallim të luftojmë korrupsionin pa pushim, çdo gjë që haset të raportoj organet përgjegjëse në mënyre që të sigurohemi se korrupsioni nuk ka vend në shoqërinë tonë. Faleminderit

**Kryetari** – Pakoja për subvencionimin e bizneseve mendoj se është në mundësinë e qeverisë së Kosovës, e cila ka të bëjë edhe me komunën tonë. Ne sa jemi të informuar zyrtarisht për bizneset të cilat e kanë të lejuar veprimtarinë e tyre, nuk përfitojnë nga pakoja mbështetëse financiare. Të gjitha bizneset tjera të cilat e kanë të ndërprere veprimtarinë e tyre për shkak të pandemisë qofshin të vogla të mesme apo të mëdha mund të aplikojnë edhe po aplikojnë për të përfituar nga pakoja që do të merr sigurisht legalitet apo legjitimitet në ditët në vijim. Njerëzit dhe familjet që janë me asistencë sociale po ashtu të gjithë personat kanë të drejtë të aplikojnë në masën 15, me 130 euro. Të larguarit nga puna gjate kohës së pandemisë që kanë qenë duke punuar nëpër biznese dhe subjekte të ndryshme prodhuese apo jo prodhuese tregtare çfarëdo qofshin do të trajtohen me pagë e asistencë dhe që buron nga kjo pakoja mbështetëse financiare. Ne si Komunë mund të debatojmë edhe si Kuvend i komunës, e dimë se nevojat janë shumë me të mëdha se sa qeveria mund ti vlerësojë. Ketë shqetësim e ndaj, e bashke secili anëtarë i kuvendit për me i subvencionua bizneset pra edhe anëtarët edhe qeveria komunale edhe unë e po besoj edhe këta të tjerët. Por të presim se çka po ndodh në proces, nëse ne nuk mund t'i hargjojmë mjetet edhe ishalla përfundon sa ma shpejt, prape jemi këtu edhe bisedojmë edhe nëse kemi mundësi me i ndihmua me kapacitetet tona buxhetore, në do të jemi këtu por të presim se çka po na ofron niveli qendrorë tashme dhe cilat janë përfitimet potenciale që njerëzit po aplikojnë në masën 15. Unë e vlerësoj përkushtimin e Fehmiut pasi është dyta herë që po e ngritë këtë temë, unë tani kam një frike prej përgjegjësisë për shkak se nuk guxoj me hapë dyer pa e ape se çfarë rezultate do të kemi nga pakoja emergjente fiskale mbështetëse bizneseve ose për rimëkëmbjen ekonomike që pritet me marr ndoshta edhe dritë jeshile ndoshta edhe në Kuvendin e Kosovës.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit Kryesues, e para që ne sot është dashtë pasi që në seancën e kaluar e kemi diskutuar edhe kemi debatuar edhe kemi lënë këtë pikë për këtë seancë me pas informatë të saktë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik unë kam menduar që do të ta formojnë një komision që u deshtë me organizua pra informatë të saktë se sa janë bizneset e vogla që me vendim të qeverisë aktualisht nuk punojnë në Komunën e Rahovecit ku janë të përfshira kafiteritë, butiqet, rrojtaret, zejtarët pra informatë edhe kur kam kërkuar subvencionim vetëm kategoritë që nuk kanë të drejtë me punue me vendim të qeverisë e jo për këta të tjerët edhe pse janë ekonomi të vogla që kanë të drejtë dhe që punojnë dhe krijojnë të hyra. Nuk e kemi një gjë të tillë edhe është mirë prape e po e themi sa saktë janë me vendim të qeverisë që nuk kanë të drejtë dhe që janë funksionale jo të regjistruara atje pasi janë mbi 2 mijë biznese. Pra nëse e keni, unë kur kam propozuar, kam menduar se ku mund të i sigurojmë këto mjete edhe nuk po e them që prapë sot me marr vendim të ngutshëm, nuk jemi duke bërë politikë absolutisht askush, të gjithë jemi të përqendruar këtu se çka mundemi me bo me mjete tona materiale të komunës edhe me i dal ndihmë bizneseve në këtë kohë pa kohë. Pra nëse e keni atë informatë atëherë në bazë të propozimit tim është deshtë me dal një vlerë monetare dhe sa është ajo vlerë që duhet me i mbulua që unë nuk e di se nuk e kam atë informatë dhe duhet të servohet, nëse jo të përgatitet për seancën tjetër. Në kuadër të kësaj që del njëfarë ndihme prapë përsëri bizneseve, ne e dimë si Komunë edhe drejtori i Financave është këtu edhe kryetari, që komunës bizneset i kanë borxh me shumë se 900,000 euro me sa e di unë që kryesisht janë taksa komunale dhe qera. I kemi shumë biznese të cilët figuron borxhi mirëpo ata janë të mbyllura komplet. E keqja më e madhe që Komuna e Rahovecit po keq klasifikohet nga auditorët e jashtëm në këtë aspekt që ka mbi 900,000 euro borxh që duhet me i inkasue, pra duhet me gjet metodën që me inkasua mirëpo ku me inkasua kur bizneset janë të mbyllura edhe drejtori i Zhvillimit Ekonomik edhe kryesuesi, po ashtu edhe kryetari ju lusë që për seancën e radhës ta përgatitni komplet sa janë borxh pra sa janë bizneset e mbyllura dhe që funksionojnë dhe të marrim një vendim ku do të propozoj unë sot këtu për seancën e radhës pasi nuk ka qenë në rendin e ditës nuk mund ta votojmë mirëpo për seancën e radhës që të bëhet

shlyerja e të gjitha borgjeve bizneset që nuk janë funksionale dhe që janë të mbyllura, e bjen një vërtetim nga ATK-ja edhe ske çka i bën pasi ai s'ka as buke me hëngër, në të shumtën e rasteve janë kësi për shkak se sikur me pas mundësi ata e kishin vazhdua biznesin, pra 100% i falet atyre që kanë të mbyllur biznesin. Pra të gjithë këta që operojnë dhe që kanë borxh 50% i falet dhe t'i caktohet një afat prej një muaji me kusht që 50% tjetër ta paguajnë menjëherë. E dhe në këtë rast unë besoj që Komuna do të inkasojë rreth 400 mijë euro dhe do të del prej keq klasifikimit të auditorit të jashtëm dhe do të ecim përpara. Për seancën e radhës, ju kisha lutur që të i sillni ato që thash edhe për propozimin parë edhe të dytin. Faleminderit

**Kryetari** – Edhe njëherë veç mos t'i ngatërrojme çështjet z. Hoxha, ne e kemi në rend dite subvencionimin e bizneseve nga Komuna. Ne kemi informatën e saktë edhe është zyrtare se cilat biznese lejohen dhe cilat biznese nuk lejohen dhe cilat veprimtari lejohen dhe cilat nuk lejohen madje e kanë të shkruar edhe me kode. Për sa i takon faljes së borxheve që në nuk po mundemi të inkasojmë, bashkë me drejtorin e Financave e kemi planifikua me u bërë kjo edhe patjetër duhet me u bë, për shkak se ka borxh që janë mbi 20vjet, natyrisht që kemi planifikuar dhe kemi propozimin konkret por njëherë nuk mundemi dhe kur të kalon pandemia pastaj do të kemi kohë me trajtua këtë pozicion të ri pasi ky është një pozicioni i ri për të cilin foli. Ne dimë saktësisht se kush ka borxh dhe kush s'mundet me i shlyer borxhet, qysh nuk mundemi me i inkasua disa borxhe për shkak se bizneset janë të mbyllura. Për sa i takon subvencionimit edhe njëherë, Komuna e Rahovecit duhet të presë se cilat janë rezultatet e aplikacioneve të bizneseve që kanë pasur të drejtë të aplikojnë për të përfutur nga pakjo emergjente fiskale e cila është prezantuar dhe shpresoj edhe njëherë të zgjerohet dhe të shtohen mjetet edhe me shume edhe të kemi pozicione shtesë për rimëkëmbje ekonomike dhe jo vetëm për mbështetje për mbijetesë. Ata janë duke aplikuar, besoj që muaji maj do të na qartësoj se ku jemi, sa jemi edhe sa përfitues ka, cilat biznese kanë përfutur edhe cilat nuk munden ose nuk kanë të drejtë të përfutojnë apo edhe të aplikojnë. Unë ju falënderoj shumë edhe sa i takon faljes së borxheve, në njërin nga seancat e ardhshme, ne do të bëjmë propozimin konkret sepse çdo qeveri bën faljet e borxheve e sidomos atyre borxheve që janë të këqija edhe ne sivjet kemi planifikua sepse vazhdimisht po na figuron nga auditori i jashtëm si borxhe të pashlyera edhe pastaj ato janë keq klasifikim e keq planifikim. Atëherë nëse nuk ka dikush tjetër diçka, nuk e di çka mundemi me biseduar diçka me shumë përveç me ju falënderuar edhe njëherë për krejt debatin konstruktiv që kemi bërë bashkë gjatë ditës së sotme në ambientin dhe në kushte të jashtëzakonshme.

**Munib Durguti** – Kryetari edhe në fillim të fjalimit e përmendi buxhetin për subvencionet e kemi të aprovuar dhe me sa e di unë është një shume prej 250,000 euro dhe po dua me dhanë një propozim konkret edhe ne arsyetim e tha se nuk kemi shume aplikacione për subvencione në aspektin kulturor, sportiv që për shkak të pandemisë kanë pushuar shumica e këtyre aktiviteteve. Ajo që po dua me dhanë propozim se kryetari e ka në diskrecionin e vet si kryetar dhe të drejtat e tjera të buxhetit për subvencione është që të ketë kujdes të veçantë për ndihma momentale. Unë e kam prej përvojës që sivjet do të ketë një fluks të madh për ndihma momentale ngase ekonomia familjare është në rënie e sipër dhe nuk e dimë se sa do të zgjasë kjo, kur kjo deri këtu po besoj që ka shkaktuar probleme të mëdha në ekonomi. Andaj propozoj që me kujdes të veçantë të shpenzohen subvencionet dhe të ju lihet një hapësirë më e madhe qytetarëve, individëve, personave fizik që aplikojnë për nevoja të ndryshme e më pak të ju jepet hapësirë sportit kulturës e kështu me radhë siç e kemi pasur në vitet e kaluara.

**Kryetari** – Ndihamat momentale nuk mund të përdoren për ekonomi me sa e dini, sepse janë kategori të subvencioneve që janë në shëndetësi, nuk guxojmë pasi ende nuk kemi filluar me shpërnda ndihma momentale për shkak se nuk e kemi pasur të drejtën me shpërnda. Subvencionet në sport, kulture e rini nuk kemi fillua me shpërndaje ende dhe as për bursa pasi jemi detyrua me shty afatin për shkak se nuk ka aplikacione për shkak të gjendjes pandemike. Ndërkohe e thashë dhe në fillim se ata që nuk ushtrojnë veprimtari nuk kemi si të ju japim subvencione, siç harrova me përmend faktin se ne kemi kategori me ndihmën e juaj siç ja keni dhënë

aprovimin buxhetit me i mbështet bizneset, kemi subvencione në bujqësi pastaj subvencione në shëndetësi për ndihma momentale për rastet shëndetësore, rastet skamnore, po ashtu ka subvencione dhe Zyra e Kryetarit, kemi subvencione kulture rini dhe sport dhe do të përpiqemi edhe përkundër faktit se ne i kemi dërguar një plan për shpërndarjen e subvencioneve sepse zyra për qeverisje të mirë e kryeministrit i ka kërkuar për çdo vit edhe tash ne ka mundësi se ka diskrepancë midis asaj që ka shkuar atje që është sipas ligjit dhe kërkesës së auditorëve dhe midis asaj se çka mundet me ndodhë për shkak se pandemia po na ndikon në rrethana tjera. Por nuk do ta lëmë as sportin as kulturën as rininë as bizneset as ndihmat momentale nuk do të lëmë pa mbështetje me kapacitetet tona buxhetore. Shpresojmë që fondi që vjen me grandin për komuna për pandemi të jetë sa më i madhe dhe të ju dalim në ndihmë edhe kategorive tjera, bizneseve apo kontingjente tjera që kanë nevojë për me i rikuperua dëmet në këtë fazë.

**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar, atëherë kolegë të nderuar unë ju falënderoj shume për kontributin e dhënë sot në këtë mbledhje në rrethana të jashtëzakonshme por edhe kjo është pjesë e jetës dhe duhet me u ballafaqua ndonjëherë edhe me këtë. Faleminderit shumë të gjithëve dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

**Mbledhja përfundoj 13:30**

01 Nr. \_\_\_\_\_ 2020  
Rahovec, 30.04.2020

**Procesmbajtësi:**

---

**Agim Hoti**

**KRYESUESI**

---

**Afrim Dina**



## Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/Opštine Orahovac/Municipal Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Department of Education



### Raport nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec për ecurinë e zhvillimit të mesimit

#### online/në distancë në nivel komune.



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA E KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu



Data: 12.05.2020

· III ·  
Nr. l prot. 1621  
Br prot. 1621  
RAHOVEC - ORAHOVAC

Më 20.05.2020  
Dl. 20.05.2020

#### Ecuria e përgjithshme e mesimit online/ në distancë

Sikur në të gjitha komunat e Kosovës ashtu edhe në komunën tonë, pas rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara përshkak të përhapjes së pandemisë COVID-19, edhe në komunën tonë filluam të angazhohemi t'i zbatojmë rekomandimet e MASHTI-t për mësimin në distancë/online. Në bazë të raporteve të SHFMU-ve dhe SHML-ve, të komunës së Rahovecit, në periudhën prej 12 marsit 2020 mesimi online është realizuar në nivel jo mjaftueshëm të kënaqshëm, marrë për bazë faktin se një sistem i tillë mesimi është realizuar për herë të parë dhe në rrethana të jashtëzakonshme. Gjatë kontakteve që kemi pasur me drejtues të shkollave dhe me numër të madh të mesimdhënësve, kjo sfidë fillimisht është pritur me skepticizëm dhe rezervë, por me anazhimin e DKA-së dhe drejtorëve të shkollave e sidomos të koordinatorëve të cilësisë, ky skepticizëm është kthyer në angazhim të madh duke e dhënë kontributin e tyre shumica e mesimdhënësve. Kjo punë është fuqizuar me krijimin e grupeve të klasave nga ku mesimdhënësit kanë përcjellur angazhimin e nxënësve përmasë deyrave të dhëna gjatë mesimit online, por edhe aktiviteteve të mesimdhënësve në klasat e tyre dhe lëndët e caktuara. Njëra ndër sfidat sipas mesimdhënësve ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike nga një numër i nxënësve me theks të veçantë me nxënës të familjeve si raste sociale dhe të komuniteteve RAE. Megjithatë, mesimdhënësit nga shkollat tona kanë evidencë

të saktë për secilin nxënës dhe mësimdhënës dhe këto evidenca do të na shërbejnë edhe për procesin e vlerësimit të nxënësve, bazuar në U.A të MASHTI-it.

Të dhënat e mëposhtme për angazhimin e mësimdhënësve dhe nxënësve në procesin e mësimin online, për aplikacionet që ata i kanë përdorur, për numrin e orëve të mbajtura, për lëndët mësimore dhe për sfidat e vëshirësitë që kemi pasur, janë paraqitur në mënyrë tabelare për të gjitha shkollat dhe për të gjitha nivelet.

**Niveli 0**

Institucioni edukativo-arsimor	Forma e aplikimit				Realizimi				Sfidat – vëshirësitë e aplikimit të mësimt online/ distancë	
	Viber	Zoom	Chat	Faceb	Nr. total i nx. në shkollë.	Nr. i nx. të angazh uar.	Nr. i mësimdh enësve.	Nr. i orëve të mbajtura.		
“Isa Boletini”	Po				125	103	3	125	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Bekim Sylka”	Po				56	49	2	80	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“G.H.Piktori”	Po				60	42	2	144	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit,

									Mjedisi	adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Sadedin Hajda”	Po			38	24	1	51		Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Lirina”	Po			24	24	1	32		Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Sapniqi”	Po			20	16	1	32		Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mesimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.

“Hamëz Thaçi”	Po					42	38	1	36	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Dëshmorët e Lirisë”	Po					20	18	1	32	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Sakip Bellaqa”	Po					18	12	1	36	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Vëllezërit Frashëri”	Po					38	38	2	64	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e





																		ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Skënder Kastrati”	Po					28	25	1	20	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.							
“Faik Konica”	Po					35	30	1	38	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.							
“Bajram Curri”	Po					59	57	2	96	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.							
“Nesimi Elshani”	Po					11	8	1	36	Matematikë, Gj. Amt are, Njeriu dhe natyra, Sh. dhe Mjedisi	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e							



Arsimi fillor 1-5

Institucioni edukativ-o-arsimor	Forma e aplikimit				Realizimi				Sfidat – vështirësitë e aplikimit të mësimin online/distance	
	Viber	zoom	Chat	face	Nr. i total i nx. në shkollë.	Nr. i nx. të angazhuar.	Nr. i mësimdhënësve	Nr. i orëve të mbajtura.		Lëndet mësimore.
“Isa Boletini”	Po	Po			554	472	23	325	Gj. Amtare, Matematikë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Bekim Sylka”	Po		Po		223	191	10	528	Gj. Amtare, Matematikë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“G.H. Piktori”	Po	Po			217	193	10	667	Gj. Amtare, Matematikë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e



										Qytetare	adaplimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Dëshmorët e Lirisë”	Po		71	62	5	280	Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkallhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.			
“Sakip Bellaqa”	Po		54	49	8	261	Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkallhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.			
“Dëshmorët e Zatriqit”	Po		34	28	5	226	Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkallhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.			
“Vëllezërit Frashëri”	Po	Po	149	100	10	300	Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe	Shkallhtësitë teknologjike nga			

										Natyrë, Edukatë Qytetare	mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarja e nxënësve, vlerësimi.
“Milaim Krasniqi”	Po	Po		Po	97	50	6	180		Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyrë, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarja e nxënësve, vlerësimi.
“Sylejman Vokshii”	Po				41	41	5	293		Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyrë, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarja e nxënësve, vlerësimi.
“Rilindja”	Po	Po			90	69	5	250		Gj. Amltare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyrë, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarja e nxënësve, vlerësimi.

“Mustafë Ibishi”	Po	Po		90	75	5	280	Gj. Amtare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“31 Marsi”	Po		Po	75	75	5	200	Gj. Amtare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Tre Dëshmorët”	Po		Po	72	55	5	258	Gj. Amtare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi.
“Rudolf Walthër”	Po	Po		168	125	10	620	Gj. Amtare, Matemati kë, Njeriu dhe Natyra, Edukatë Qytetare	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e

																			nxënëseve, vlerësimi.
“4 Dëshmorët”	Po	Po	Po	291	256	14	864	Gj.Amtare,Matemati kë,Njeriu dhe Natyra,Edukatë Qytetare	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënëseve, vlerësimi.										
“Skënder Kastrati”	Po	Po	186	159	10	640	Gj.Amtare,Matemati kë,Njeriu dhe Natyra,Edukatë Qytetare	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënëseve, vlerësimi.											
“Faik Konica”	Po	Po	126	118	7	432	Gj.Amtare,Matemati kë,Njeriu dhe Natyra,Edukatë Qytetare	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënëseve, vlerësimi.											
“Bajram Curri”	Po	Po	224	202	10	496	Gj.Amtare,Matemati kë,Njeriu dhe Natyra,Edukatë Qytetare	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga											









“Sakip Bellaga”	Po			Po	41	39	8	280	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“Dëshmorët e Zatriqi”	Po	Po			23	16	8	432	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“Vëllezërit Frashëri”	Po	Po		Po	119	85	11	356	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“Milaim Krasniqi”	Po			Po	74	55	10	450	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze,	Shkathësitë teknologjike nga

										Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“Sylejman Vokshi”	Po	Po	25	25	8	428	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi			
“Rilindja”	Po	Po	68	47	7	173	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi			
“Mustafë Ibishi”	Po	Po	77	63	8	324	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë	Shkathhtësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat			

											,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“31 Marsi”	Po			Po	66	56	8	318		Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi	
“Tre Dëshmorët”	Po			Po	84	61	8	310		Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi	
“Rudolf Walthër”	Po	Po		Po	141	120	12	368		Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gje ografi, Ed. Qytetar	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu	

									e etj.	edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
“4 Dëshmorët”	Po	Po	Po	263	188	12	642	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi	
“Skënder Kastrioti”	Po	Po		169	125	12	468	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi	
“Faik Konica”	Po	Po	Po	81	69	10	568	Gj. Shqipe, Gj. Ang leze, Matematikë, TIK, Fizikë ,Kimi, Histori, Gjeografi, Ed. Qytetar e etj.	Shkathësitë teknologjike nga mësimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mësimdhënësit,	





Arsimi i mesëm i lartë 10-12

Institucioni edukativo-arsimor	Forma e aplikimit				Realizimi				Sfidat-vështirësit e aplikimit të mesimit online/distançë.
	viber	zoo m	Chat	fac	Nr. i total i nx. shkollë.	Nr. i nx. të angazh uar.	Nr. i mesimdhë nësve.	Nr. i orëve të mbajtur a.	
SHML-Gjimmazi "Xhelal Hajda-Toni" Rahovec	Po	Po	Po	Po	666	457	45	1420	Shkathësitë teknologjike nga mesimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
SHML"Ukshin Hoti	Po	Po		Po	304	181	22	1446	Të gjitha, me përjashtim të Mësimit me Zgjedhje
SHML"12 Maji"	Po	Po		Po	362	289	27	610	Të gjitha, me përjashtim të Mësimit me Zgjedhje
									Shkathësitë teknologjike nga mesimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi
									Shkathësitë teknologjike nga mesimdhënësit, adaptimi me sfidat e reja si nga nxënësit ashtu edhe nga mesimdhënësit, pjesëmarrja e nxënësve, vlerësimi





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 05/20  
Rahovec, 21.05.2020

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më  
29 maj 2020 (e premte) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REN DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për bartjen e tejkalimit të të hyrave vetanake nga viti 2019;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit të kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme – lokaleve afariste të Komunës në shfrytëzim personave juridik;
6. Shqyrtimi i Raportit të DKA-së për ecurinë e zhvillimit të mësimin online, në distancë;





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 27 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i datës 13.03.2008 dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.05.2020 merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për bartjen e tejkalimit të të hyrave vetanake nga viti 2019**

- 1. Miratohet vendimi për bartjen e tejkalimit të të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2019 dhe bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2019 në vitin 2020.**
- 2. Qëllimi i miratimit të këtij vendimi të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është tejkalimi I të hyrave të planifikuara për vitin 2019 dhe bartja e mjeteve në vitin 2020 në kuadër të investimeve kapitale.**
- 3. Bartja e të hyrave vetanake të cekura në pikën 2 të këtij vendimi është në shumën prej 139,750.37€ (njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent), të cilat shpërndahen si vijon:**
  - 3.1.Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nën programin Administrata (92055), kodi funksional (0980), bartet në projektin Ngrohje qendrore për shkollat e Komunës së Rahovecit, kodi 48235, shuma prej 36,000.00€ (tridhjetë e gjashtë mijë euro).**
  - 3.2.Në programin Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia (180), nën programin Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451), bartet në projektin Ndërtimi I sistemeve të ujësjellësit në Komunën e Rahovecit, kodi 40819, shuma prej 20,000.00€ (njëzet mijë euro).**
  - 3.3.Në programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nën programin Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700), kodi funksional (0721), bartet në projektin Ndërtimi i Qendrës Kryesore të mjekësisë familjare, kodi (45693), shuma prej 61,750.37€ (gjashtëdhjet e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent).**
  - 3.4.Në programin Zhvillimi Ekonomik (480), nën programin Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011), kodi funksional (0411), bartet në projektin Investime në Zonën Ekonomike në Oploterushë, kodi (45690), shuma prej 22,000.00€ (njëzet e dy mijë euro).**
- 4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.**

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Kryetari të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

## **KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01Nr. \_\_\_/2020**  
**Datë: 29.05.2020**

**Afrim Dina**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo  
Komuna e Rahovecit / Opština Oraovac / Municipal of Rahovec  
Drejtoria për Financë dhe Buxhet-Odeljenje za Finansije i Budzet  
-Department of Finance and Budget



Rahovec 12.05.2020

**PROPOZIM PËR BARTJEN E TEJKALIMIT TË HYRAVE VETANAKE NGA**

**VITI 2019**

-Planifikimi i të hyrave 2019-----1,168,768,00

-Realizimi i të hyrave 2019-----1.308.518.37

-Tejkalimi i të hyrave 2019-----139.750.37

Bartja e tejkalimit të hyrave, të shpërndahen në kuadër të Investimeve Kapitale si vijon:

- Nën programit Arsim dhe Shkencë (920) ,nën programin Administrata (92055) , kodi funksional (0980), në projektin:

-Ngrohje qendrore për shkollat e komunës së Rahovecit, kodi 48235 shuma 36,000 €

- Në programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180) ,nën programin Infrastruktura Publike (18171) , kodi funksional (0451), në projektin:

-Ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit më Komunën e Rahovecit ,kodi 40819 shuma 20,000 €

- Në programin Shëndetësia dhe mirëqenie sociale (730),nen programi Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73700) , kodi funksional (0721), në projektin:

-Ndërtimi i Qendrës kryesore te mjekësisë familjare-emergjenca, kodi (45693),shuma 61,750.37 €

- Në programin Zhvillimi Ekonomik (480),nen programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik (48011) , kodi funksional (0411), në projektin:

-Investime ne zonën Ekonomike Apterushe, kodi(45690),shuma 22.000 €

Drejtor për Buxhet dhe Financa

Afrim Limani





Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/ 2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/2019), nenit 10, 39, 40, 46, 57 dhe nenit 94 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.05.2020 merr këtë:

### V E N D I M

#### Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

1. Miratohet vendimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/371/20 i datës 10.03.2020 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë në zonën kadastrale Radostë, e evidentuar sipas Certifikatës së pronësisë në emër të P.Sh.E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 769 m<sup>2</sup> (shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë metra katror) me numër të certifikatës së pronësisë si në vijim:
  - 2.1.Pjesa e parcelës kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510067-00319-1 në sipërfaqe prej 136 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 345 m<sup>2</sup>;
  - 2.2.Pjesa e parcelës kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510067-01646-0 në sipërfaqe prej 56 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 16531 m<sup>2</sup>;
  - 2.3.Pjesa e parcelës kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510067-00303-0 në sipërfaqe prej 577 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17236 m<sup>2</sup>.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është interes i përgjithshëm si dhe ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, në të cilën planifikohet të ndërtohet një odë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e fshatit Radoste.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.
5. Pronat e cekura në pikën 2 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim pa kompensim në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.
6. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të këtij vendimi të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. 01/57/20 i datës 30.03.2020.
10. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01Nr. \_\_\_\_/20**  
**Me datë: 29.05.2020**

**Afrim Dina**  

---

**Kryesues i Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odehenje za Opštu Upravu

-III- Nr i prot. 867 Më 28.02.2020  
Dr prot. 01 Di  
RAHOVEC - ORAHOVAC

**KOMUNËS SË RAHOVECIT**  
**-Krytarit të Komunës -**

**Lënda: Kërkesë për dhënjën në shfrytëzim të parcelës P-71510067-00303-0 ZK Radostë.**

Me anë të kësaj kërkesë titullit të lartëpërmendur unë kryetari i fshatit Radostë, me pëlqimin e Këshillit të fshatit dhe të gjithë banorve të fshatit, bëjë kërkesë që në parcelën P-71510067-00303-0 ZK Radostë, të na ipet e drejta që në këtë parcelë të ndërtojmë një odë për të gjitha nevojat e fshatit, ku në këtë odë mendojmë që në të ardhmen të kryhet çdo aktivitet i cili është në interesin e të gjithë banorëve të fshatit tonë.

Sipërfaqja që kërkojmë të na jepë Komuna për ndërtimin e kësaj ode duhet të jetë (12-ari.) 7ARI E 69 M2 (n<sup>o</sup> m<sup>2</sup>)

Kërkesa ime dhe e Këshillit të fshatit dhe e të gjithë banoëve mendojmë që është e bazuar në ligj dhe në rregulloret në fuqi të Komunës.

Kësaj kërkesë ia kemi bashkangjitur Kopjen e Planit dhe Planin e punuar nga Arkitekti se si ka me u dukur Oda – objekti.

a n d a j

Unë Kryetari i fshatit, Këshilli i fshatit dhe të gjithë banorët e fshatit Radostë, me anë të kësaj kërkesë, kërkojmë që kjo kërkesë e jonja do të A P R O V O H E T dhe të na mundësohet dhe lejohet që ta ndërtojmë me parat e tona në parcelën e Komunës me nr. P-71510067-00303-0 ZK Radostë Odën – objektin për nevojat e banorëve të fshatit Radostë.

Radostë,  
28.02.2020


Kërkesën e parashtrori  
Enver Çadraku, Krytar i fsh.Radostë



### Skica e terrenit

Z.K. Radoste

P/1:300



